



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI**  
**I**  
**TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT**

Mbi Auditimin e Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit,  
në Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial



*Tiranë, Prill 2023*



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI MBI AUDITIMIN E SISTEMEVE TË**  
**TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT NË INSPEKTORATIN SHTETËROR**  
**TEKNIK DHE INDUSTRIAL**

**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI**

**“MBI AUDITIMIN E SISTEMEVE TË TEKNOLOGJISË SË**  
**INFORMACIONIT NË INSPEKTORATIN SHTETËROR TEKNIK DHE**  
**INDUSTRIAL”**

**Tiranë, Prill 2023**

## PËRMBAJTJA

Nr.	EMËRTIMI	Faqe
<b>I.</b>	<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	4
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	4
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	5
3.	Konkluzioni i përgjithshëm i auditimit	8
<b>II.</b>	<b>HYRJA</b>	8
1.	Objekti i auditimit	8
2.	Qëllimi i auditimit	8
3.	Identifikimi i çështjes	8
4.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	9
5.	Përgjegjësitë e audituesve	9
6.	Kriteret e vlerësimit	10
7.	Standardet e auditimit	10
8.	Metodat e auditimit	11
9.	Dokumentimi i auditimit	11
<b>III.</b>	<b>PËRSHKRIMI I AUDITIMIT</b>	12
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	12
2.	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	12
2.1	Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK	
a.	<i>Strategjia, procedurat dhe rregulloret në TIK si dhe vlerësimi i burimeve njerëzore në TIK</i>	12-16
2.2	Auditimi i Sigurisë së Informacionit	
a.	<i>Identifikimi dhe adresimi i risqeve në TIK</i>	16-22
b.	<i>Verifikimi i shkallës së sigurisë fizike dhe aksesit në rrjet</i>	
2.3	Auditimi i zhvillimit dhe blerjes në teknologjinë e informacionit	23-33
2.4	Auditimi i sistemeve	
a.	<i>Të drejtat e përdoruesve dhe menaxhimi i tyre</i>	34-51
b.	<i>Verifikim i kontrolleve të aplikacioneve për të dhënat Input/Output</i>	
<b>IV.</b>	<b>GJETJET DHE REKOMANDIMET</b>	51
A.	<b>Masa Organizative</b>	51

## ⌘ LISTA E SHKURTIMEVE

<b>Shkurtimi</b>	<b>Emërtimi i plotë</b>
<b>KLSH</b>	- Kontrolli i Lartë i Shtetit
<b>INTOSAI</b>	- Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.
<b>AKSHI</b>	- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
<b>VKM</b>	- Vendim i Këshillit të Ministrave
<b>ISHTI</b>	- Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial
<b>IQ</b>	- Inspektorati Qendror
<b>MIE</b>	- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
<b>TIK</b>	- Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
<b>DDOS</b>	- Distributed Denial-of-Service
<b>TI (IT)</b>	- Teknologji Informacioni
<b>BCP</b>	- Business Continuity Plan
<b>BCC</b>	- Business Continuity Center
<b>DRC</b>	- Disaster Recovery Center
<b>RTO</b>	- Objektivat e Kohës së Rimëkëmbjes
<b>RPOs</b>	- Objektivat e Punës së Ripërtëritjes
<b>OE</b>	- Operator Ekonomik
<b>AK</b>	- Autoriteti Kontraktor
<b>IP</b>	- Internet Protocol
<b>VPN</b>	- Virtual Private Network
<b>KVO</b>	- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
<b>VLAN</b>	- Virtual Local area network
<b>DST</b>	- Dokumenta Standarde të Tenderit
<b>APP</b>	- Agjencia e Prokurimit Publik
<b>MFK</b>	- Menaxhimi Financiar dhe Kontrollit
<b>LPP</b>	- Ligji për Prokurimin Publik
<b>AKEP</b>	- Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
<b>BI</b>	- Business intelligence
<b>VOIP</b>	- Voice over Internet Protocol
<b>DVR</b>	- Digital video recorder
<b>NVR</b>	- Network video recorder
<b>NAS</b>	- Network Attached Storage
<b>SAN</b>	- Storage Area Network
<b>PTC</b>	- Postal Technology Center
<b>ALCIRT</b>	- Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike
<b>AKCESK</b>	- Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike
<b>ISACA</b>	- Information Systems Audit and Control Association
<b>IPS</b>	- (Immovable Property System)
<b>SQDNE</b>	- Sistemi i Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik

## **I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) mbështetur në nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, datë 27.11.2014, zhvilloi një Auditim të Teknologjisë së Informacionit në Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial, nga data 16.01.2023 deri më datë 15.03.2023.

Grupi i auditimit mblodhi informacione, zhvilloi pyetësorë e intervista për caktimin e zonave me risk të lartë dhe mbështetur në to hartoi matricat e auditimit.

Kërkesat për informacion për fushat përkatëse u hartuan në përputhje me manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

### **I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit**

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) mbështetur në nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, datë 27.11.2014, zhvilloi auditimin teknologjisë së informacionit në Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial, nga data 16.01.2023 deri më datë 15.03.2023. Auditimi i Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit, në Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial, ka qenë pjesë e planit të auditimit të KLSH-së, miratuar për muajin Janar nga Kryetari i KLSH.

Projektimi i këtij auditimi, është bërë bazuar në një analizë risku, si gjatë hartimit të planit vjetor, po ashtu edhe gjatë hartimit të Programit të Projektit të Auditimit, ku KLSH, ka vlerësuar si të rëndësishëm auditimin e sistemeve të teknologjisë që Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial përdor, për të garantuar disponibilitet dhe integritet të të dhënave.

Pas marrjes së ambienteve të përshtatshme, grupi i auditimit, filloi fazën e studimit paraprak, ku u dërgua pyetësori i hartuar, bazuar në Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit. Grupi i auditimit ka vlerësuar ato fusha që kanë rezultuar si fusha me risk dhe hartoi programin e auditimit. Programi i auditimit me nr. 1189/1 u miratua nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me datë 13.01.2023.

Auditimi i teknologjisë së informacionit është ekzaminimi i implementimit të sistemeve IT për të siguruar përmbushjen e nevojave të institucionit apo organizatës pa kompromentuar sigurinë, privatësinë, koston dhe elementet e tjera kritike të institucionit.

Si pasojë e rritjes së kompleksitetit të kontrollit të aksesit dhe ruajtjes së konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë së të dhënave nga marrëdhëniet e rrjeteve publike me ato private, siguria e informacionit është bërë gjithnjë e më shumë e rëndësishme për institucionet. Siguria e Informacionit mund të përcaktohet si mundësia e një sistemi për të mbrojtur informacionin dhe burimet e sistemeve në përputhje me termat e konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë.

Sistemet e informacionit janë bashkime komplekse të teknologjisë, proceseve dhe njerëzve që funksionojnë së bashku për të rregulluar përpunimin, ruajtjen, dhe transferimin e informacionit për të mbështetur misionin e institucionit dhe funksionet e tij. Lidhur sa më sipër, çdo institucion shtetëror që ofron shërbime ndaj qytetarëve e ka si detyrim ndërtimin e programit të sigurisë së informacionit me elementët kyç të cilët janë: “*Mjedisi i sigurisë së informacionit, vlerësimi i riskut, politikat e sigurisë, organizimi i sigurisë së teknologjisë së informacionit, menaxhimi i komunikimeve dhe operacioneve, menaxhimi i aseteve, siguria e burimeve njerëzore, siguria fizike dhe mjedisore, kontrolli i aksesit, menaxhimi i vazhdueshmërisë së biznesit, etj*”.

## I.2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Gjetjet kryesore, të paraqitura në këtë Raport Përfundimtar Auditimi në mënyrë të përmbledhur sipas drejtimeve të auditimit, rezultuan si më poshtë:

Gjetja Nr.	Përmbledhje e Gjetjes	Referenca me Raportin Përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
1	Nga auditimi u konstatua se ISHTI akoma nuk e ka përfunduar procesin e kalimit tek Agjencia e Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, të burimeve njerëzore si dhe dorëzimin e Infrastrukturës TIK ekzistuese nën administrimin dhe inventarin e ISHTI-t, së bashku me të drejtat dhe detyrimet juridiko-civile, sipas përcaktimeve dhe afateve të vendosura në VKM Nr. 673, datë 22.11.2017, “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar.	faqe 12-16	e lartë	Organet drejtuese në Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial të marrin masa për kalimin e strukturave përgjegjëse TIK si dhe kalimin e aktiveve të sistemeve të informacionit të ISHTI-t tek Agjencia e Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, së bashku me të drejtat dhe detyrimet juridiko-civile sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.
2	Shërbimet që ofron teknologjia e informacionit në ISHTI mbështetet në një infrastrukture IT jo të konsoliduar dhe në disa pjesë është e amortizuar, konkretisht: - Pajisjet Pc kanë parametra minimale specifike dhe përgjithësisht kanë të instaluar sistemin operativ “Windows 7”, sistem për të cilin edhe vetë “Microsoft” që është prodhuesi i tij e ka ndërprere suportin për sistemin dhe nuk e rekomandon përdorimin e tij në vijimësi, duke i bërë pc-të e punonjësve dhe rrjetin network të ISHTI-t vulnerabël ndaj sulmeve dashakeqe. - Pajisjet Pc nuk kanë të instaluar software Antivirus; - Sistemet e operemit apo edhe software-t (si Office) e instaluar nëpër pc janë të pa licencuara; - Pajisjes periferike si printera janë kryesisht modele të vjetra por edhe të amortizuara, ku në të shumtën e rasteve, vështirë të gjendet bojë, pasi janë me bojra me rezervuar të lëngshëm ose “ink cartridge”.	faqe 16-22	e lartë	Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë të marrë masa për përmirësimin, pajisjen dhe standartizimin e infrastrukturës TIK për punonjësit e administratës së ISHTI, me qëllim krijimin e kushteve optimale për përbushjen e detyrave gjatë veprimtarisë së punës dhe mbarëvajtjen e punës pa ndërprerje.
3	Nga auditimi u konstatua se: - Fjalëkalimi i secilit përdorues në sistemin e-inspektimi në momentin e çeljes, sapo logohet përdoruesi (first login) me fjalëkalimin fillestar nuk të shfaqet automatikisht tabela e cila të kërkon vendosjen e fjalëkalimit të ri, ruajtjen e tij dhe rilogimin përsëri me anë të fjalëkalimit të ri. - Sistemi nuk e ka të parametrizuar që pas një periudhe të standardizuar 30 ditore, automatikisht të të kërkojë rigjenerimin e fjalëkalimit. - Nuk janë dokumentuar politikat e sigurisë të implementuara për përdoruesit e sistemit, si dhe detyrimet që nevojiten të aplikohen në fjalëkalimet e tyre, bazuar në pikën 4 “Kërkesat e Sigurisë” pika a. të rregullores për “Administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike” të miratuar nga AKCESK me urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019. - Nuk janë dokumentuar politikat e sigurisë të implementuara për fjalëkalimet e sistemeve qendrore dhe administrimit bazuar në pikën 4 “Kërkesat e Sigurisë” pika b. Të rregullores për “Administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike” miratuara nga AKCESK me urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019.	faqe 34-51	e lartë	Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial në bashkëpunim me Inspektoratin Qendror (IQ) të marrin masa për të dokumentuar politikat e sigurisë të implementuara për përdoruesit e sistemit, si dhe detyrimet që nevojiten të aplikohen në fjalëkalimet e tyre sipas përcaktimeve rregullatore të AKCESK. Gjithashtu të merren masa për adresimin e çështjeve të konstatuar nga grupi i auditimit, me qëllim rritjen e sigurisë së identifikimit të përdoruesve.

	<p>- Mbështetur në manualin e përdorimit për burimet njerëzore të sistemit për shtimin e një përdoruesi të ri është e detyrueshme që të vendoset një foto, por nga verifikimi në sistem rezultuan që ka disa përdorues të ISHTI-t që nuk kanë foto.</p>			
4	<p>Nga auditimi mbi funksionalitetin e sistemit e-inspektimi u konstatua se:</p> <p>Në modulën e “çështjeve të inspektimit” u konstatua se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Në disa raste gjatë zhvillimit të procesit inspektues, përdoruesve u shfaqën problematika mbi gjenerimin e vendndodhjes në tablet;</li> <li>-Në momentin kur inspektori në çështjen përkatëse e krijon si ri-inspektim ato në sistem dalin të krijuara dy herë;</li> <li>-Në disa raste është vërejtur se inspektorët, pasi gjenerojnë dokumentet si, Proces Verbalin, Listë Verifikimit dhe Vendimin Përfundimtar, statusi i këtyre çështjeve nuk del “Mbyllur” por vazhdon të jetë në progres;</li> <li>-Përgjatë vitit 2022 janë hasur raste në versionin web dhe mobile ku sistemi nuk hapej dhe shfaqte error: “Service is unavailable” dhe “HTTP error 503”;</li> <li>-Në disa raste në versionin web të sistemit e-inspektimi është hasur një error i cili shfaqej: “Lidhje me serverin dështoi”;</li> <li>- Gjatë procesit të inspektimit është hasur një problematikë nga inspektorët të cilët pasi mbyllin procesin e inspektimit në sistem dhe më pas u duhet të dërgojnë në format elektronik “e-mail” të dhënat përkatëse, u konstatua se ky e-mail nuk shkon në destinacionin e përcaktuar;</li> <li>-Kur krijohen çështjet në modulën e çështjeve dhe programimit, emri i një subjekti që përsëritet më shumë se 15 herë, nuk mund të regjistrohet në sistem. Për këtë arsye për të futur të gjithë subjektet e programuara në planin vjetor, ato regjistrohen në sistem në modulën e-inspektimit/skeduli i çështjeve, me statusin “të programuara”. Praktikisht plani vjetor është në letër por nuk mund të hidhet i gjithi në sistem për shkak të kësaj problematike mbi përsëritjen e të njëjtit nipt. Kjo gjë krijon probleme pasi ka kompani të cilat kanë më shumë se një degë në të gjithë vendin por kanë një nipt të vetëm. Pra praktikisht këto subjekte nuk mund të inspektohen më shumë se 15 herë për shkak të pengesës së trajtuar më lart në sistem, edhe pse kanë më shumë degë në të gjithë vendin;</li> <li>-Tek moduli i çështjeve të inspektimit nuk shfaqen të gjitha ri-inspektimet dhe kur kërkohet me arsyen ri-inspektim.</li> </ul> <p>Në modulën “krijo çështje” u konstatua se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Në fazën e një procesi inspektimi jashtë planit vjetor dhe mujor, mungon mundësia e zgjedhjes së një arsyeje tjetër përveç atyre të paracaktuara në sistem. Mundësia e shtimit të arsyeve ose argumenteve sipas argumenteve specifike që inspektori e gjykon sipas situatës që konstaton, do të lehtësonte procesin e inspektimit në fazë;</li> <li>-Në modulën e çështjeve të inspektimit tek fusha “inspektori”, përdoruesi nuk ka një opsion zgjedhjeje për të shkruar ose për të kërkuar (search) emrin e plotë të inspektorit që do të shtojë ose përzgjedhë;</li> <li>-Përditësimi i degëve të subjektit nuk realizohet automatikisht tek fusha bizneset pa bërë search manual tek fusha bizneset.</li> </ul> <p>Në modulën e “programimit” u konstatua se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Inspektorët e larguar duhet të jenë jo aktiv të paselektueshëm kur krijojnë çështje “Tek përcaktimi i programeve mujore”;</li> </ul> <p>Në modulën e “skeduli i çështjeve” u konstatua se:</p>	faqe 34-51	e lartë	<p>Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial në bashkëpunim me Inspektoratin Qendror të analizojë dhe adresojë tek ofruesi i shërbimit të mirëmbajtjes parregullsitë, mangësitë e konstatuara nga auditimi dhe të ofrojnë zgjidhje për to me qëllim përmirësimin e performancës së funksionimit të sistemit e-inspektimi, si dhe të merren masa për shtimin e funksionaliteteve të reja në sistemin e-inspektimi sipas nevojës së përdoruesve në sistem.</p>

	<p>Sistemi nuk të ofron mundësi që të zgjedhësh një arsye tjetër përveç asaj të paracaktuarës dhe nuk ke mundësi të upload-osh dokumentin justifikues që citohet në përshkrimin e anulimit. Kjo gjë ndikon negativisht, në ndërprerjen e gjurmës së auditimit, pasi për të parë të gjithë procesin në sistem se pse është anuluar një çështje, do të duhet ta lexosh numrin e shkresës së hedhur manualisht në sistem dhe pastaj të shkosh në zyrën e protokoll arkivës për të marrë dokumentin justifikues me argumentet përkatëse.</p> <p>Mbi shtyrjen e një procesi inspektues</p> <p>Në rastet kur një proces inspektimi shtyhet për një arsye të caktuar dhe procesi i inspektimit nuk realizohet në periudhën e përcaktuar në autorizimin e parë të Kryeinspektorit, atëhere procesi duhet të rivijojë me një autorizim të ri që shtyhet në periudhën për javën pasardhëse. Nga auditimi u konstatua se sistemi e-inspektive nuk ka element kontrolli mbi këtë fazë dhe i lejon inspektorët që të procedojnë në sistem me procesin e inspektimit me plotësimin e hapave të mëtejshëm edhe pse nuk është hedhur akoma autorizimi i ri në sistem që duhet aprovuar nga Kryeinspektori. Në këto raste autorizimi i ri miratohet pasi ka mbaruar i gjithë procesi i inspektimit dhe është dhënë dhe vendimi përfundimtar.</p> <p>Pra sistemi nuk ia ndërpret procesin inspektorit që të vazhdojë në hallkat e tjera por ja lejon atij të vazhdojë të kryejë procesin inspektues pa u miratuar akoma autorizimi i ri nga Kryeinspektori.</p>			
5	<p>Nga auditimi u konstatua se:</p> <p>-Versioni mobile i sistemit e-inspektimi vazhdimisht punon me ndërprerje dhe ka probleme me ecurinë normale të punës duke ndikuar negativisht në veprimtarinë e punës së inspektorëve. Ky version ka nevojë për përditësime dhe upgrade.</p>	faqe 34-51	e lartë	<p>Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial në bashkëpunim me Inspektoratin Qendror të analizojë dhe adresojë tek ofruesi i shërbimit të mirëmbajtjes parregullsitë, mangësitë e konstatuara nga auditimi në aplikacionin mobile të sistemit e-inspektimi. Të përditësojnë aplikacionin mobile dhe të ofrojnë zgjidhje për mangësitë e konstatuara me qëllim përmirësimin e performancës së funksionimit të aplikacionit e-inspektimi, si dhe të merren masa për sigurimin e internetit në pajisjet tablet të inspektorëve të ISHTI në mënyrë që inspektorët të ushtrorjnë veprimtarinë e tyre inspektuese në terren pandërprerje.</p>



### **I.3. Konkluzioni i përgjithshëm i auditimit:**

Grupi i auditimit mbështetur në Standardet ndërkombëtare të Auditimit përkatësisht në ISSAI 100, ISSAI 5300, ISSAI 5310 si dhe nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH" datë 27.11.2014 konstaton se, mungesa e strategjisë, akteve rregullative, pajisjeve kompjuterike dhe internetit në tabletat për inspektim, problematikat në funksionalitetet e sistemit "e-inspektimi", janë disa nga faktorët kryesorë që kanë ndikuar në cilësinë dhe saktësinë e të dhënave që gjeneron Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial .

Sistemi e-inspektimi vazhdimisht punon me ndërprerje dhe ka probleme gjatë procesit të inspektimit duke ndikuar negativisht në veprimtarinë e punës së inspektorëve në ofrimin e shërbimeve kundrejt bizneseve dhe qytetareve.

Në gjykimin tonë, identifikimi dhe administrimi i elementëve kritikë në infrastrukturën network dhe atë kompjuterike është i pamjaftueshëm, si dhe shërbimet që ofron teknologjia e informacionit në ISHTI mbështeten në një infrastrukturë IT jo të konsoliduar.

## **II. HYRJJA**

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH*", në zbatim të Programit të Auditimit nr. 1189/1 prot, datë 13.01.2023 miratuar nga Kryetari i KLSH, me afat auditimi 16.01.2023 deri në 15.03.2023, në subjektin e auditimit "*Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial*", ku periudha e audituar është 01.01.2020 deri në 31.12.2022, u krye auditimi me objekt "*Auditimi i Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit*", nga audituesit:

1. B.H, *përgjegjës grupi*
2. M.P, *anëtare*
3. K.S, *anëtare*

### **II.1. Objekti i auditimit:**

Përcaktimi nëse objektivat e subjektit arrihen në mënyrën e duhur duke përdorur burimet IT, duke përfshirë pajtueshmërinë me kërkesat ligjore dhe rregullative, konfidencialitetin, integritetin si dhe disponueshmërinë e sistemeve të informacionit dhe të dhënave që gjenden në të.

### **II.2. Qëllimi i auditimit:**

Vlerësimi nëse ekzistojnë kontrollet dhe mekanizmat e duhur me qëllim krijimin, mirëmbajtjen, zhvillimin e burimeve IT dhe funksioneve për të cilat këto burime shërbejnë. Objektivat e këtij projekt auditimi, u vendosën në koherencë me veprimtarinë, qëllimin dhe objektivat e inspektoratit, duke marrë në konsideratë të gjithë kuadrin rregullator në bazë të të cilit institucioni zhvillon veprimtarinë e tij. Për të arritur në dhënien e një opinioni, janë mbledhur informacione, të dhëna dhe prova, për të përcaktuar nëse nëpërmjet teknologjisë së informacionit mbrohen asetet, ruhet integriteti i të dhënave, si dhe synimet e subjektit që auditohet arrihen në mënyrë efektive duke përdorur burimet në mënyrë eficiente.

### **II.3. Identifikimi i çështjeve:**

Drejtimet e këtij auditimi janë bazuar në programin e protokolluar në KLSH me nr. 1189/1, datë 13.01.2023:

## **1. Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK**

- *Strategjia, procedurat dhe rregulloret në TIK si dhe vlerësimi i burimeve njerëzore në TIK.*

## **2. Auditimi i Sigurisë së Informacionit**

- *Identifikimi dhe adresimi i risqeve në TIK;*

- *Verifikimi i shkallës së sigurisë fizike dhe aksesit në rrjet.*

## **3. Auditimi i zhvillimit dhe blerjes në teknologjinë e informacionit**

## **4. Auditimi i sistemeve**

- *Të drejtat e përdoruesve dhe menaxhimi i tyre;*

- *Verifikim i kontrolleve të aplikacioneve për të dhënat Input/Output.*

## **5. Të ndryshme të dala gjatë auditimit**

*Në këtë pikë, grupi i auditimit ka përfshirë të gjitha ato çështje të pa adresuara që kanë dalë nga auditimi dhe janë gjykuar me siguri të arsyeshme nga grupi i auditimit për tu përfshirë në raportin e auditimit.*

### ***II.4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar:***

Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial është institucion publik buxhetor në varësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Detyrat, kompetencat dhe funksionet e tij të përgjithshme dhe të veçanta përcaktohen në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 410, datë 13.05.2015, “*Për krijimin, organizimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial*”.

Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial është strukturë përgjegjëse për inspektimin, për zbatimin dhe përmbushjen e kërkesave ligjore dhe nënligjore në fushën e:

- përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre, sipas legjislacionit përkatës;

- sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve elektrike, sipas legjislacionit përkatës;

- sigurisë së punës së instalimeve nën presion, si një linjë teknologjike e përbërë nga enë, tubacione dhe aksesore sigurie, që shërbejnë për mbajtjen, trajtimin dhe shpërndarjen e fluideve, sipas legjislacionit për sigurinë e enëve nën presion;

- sigurisë së punës në veprimtarinë e sektorit të gazit natyror, përfshirë transmetimin, shpërndarjen, depozitimin, si dhe ndërtimin e operimin e infrastrukturës së gazit natyror, sipas legjislacionit të sektorit të gazit natyror;

- sigurisë teknike të linjave teknologjike industriale të industrisë jo ushqimore, brenda fushës së përgjegjësisë së ministrisë përgjegjëse për industrinë, sipas legjislacionit përkatës;

- çdo përgjegjësi tjetër të përcaktuar me ligj apo akt nënligjor.

### ***II.5. Përgjegjësitë e audituesve:***

Kontrulli i Lartë i Shtetit, auditoi Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial, për periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2020 deri në 31.12.2022, duke i kushtuar vëmendje çështjeve që lidhen me cilësinë e shërbimeve të ofruara nëpërmjet sistemeve të teknologjisë së informacionit, sigurisë së të dhënave dhe arritjes së objektivave institucional nëpërmjet përdorimit të burimeve të TIK.

Nga grupi i auditimit, me përgjegjësi të plotë, janë analizuar të gjitha çështjet që përmban Programi i Auditimit nr. 1189/1, datë 13.01.2023, miratuar nga Kryetari i KLSH. Në realizimin e këtij Projekt Auditimi, grupi i auditimit është mbështetur në bazën ligjore mbi të cilën funksionon KLSH, standardet e auditimit si dhe në legjislacionin e fushës në të cilën operon Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial. Gjithashtu, gjatë veprimtarisë audituese, është siguruar një evidencë e përshtatshme auditimi, në të cilën jemi mbështetur për nxjerrjen e konkluzioneve dhe dhënien e rekomandimeve.

## **II.6. Kriteret e vlerësimit:**

Kriteret e vlerësimit janë bazuar në ligjet, rregulloret në fuqi, standardet ndërkombëtare COBIT dhe ISSAI 5300 për auditimin e Teknologjisë së Informacionit si dhe Manualin e Teknologjisë së Informacionit. Opinioni i auditimit mbështetet në praktikat më të mira, Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Auditimit. Në këtë projekt raport krahas gjetjeve që janë konstatuar, grupi i auditimit ka rekomanduar disa masa organizative për përmirësimin e situatës.

*Aktet ligjore dhe rregullative mbi të cilat është mbështetur vlerësimi janë si më poshtë:*

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (*nenet 162-165 si dhe nenet 78, 83*);
- Ligji nr. 154/2014 *“Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”*;
- Ligji nr. 9918, datë 19.05.2008 *“Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 10325, datë 23.09.2010, *“Për Bazat e të Dhënave Shtetërore”*;
- Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar;
- Ligji nr. 2/2017, *“Për Sigurinë Kibernetike”*;
- Ligji nr.1029, datë 08.07.2010 për *“Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”*;
- Ligji nr.114/2015 për *“Auditimin e brendshëm në sektorin publik”*;
- Ligji Nr. 119/2014 *“Për të drejtën e informimit”*;
- Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar;
- Ligji nr. 7691 datë 12.07.1995 *“Kodi i punës”* i ndryshuar;
- Ligji Nr. 10433, datë 16.06.2011 *“Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”*;
- VKM nr. 410 datë 13.05.2015 *“Për Krijimin, Organizimin dhe Funksonimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial”*;
- VKM nr. 673, datë 22.11.2017 *“Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”*, i ndryshuar;
- VKM nr. 710, datë 21.08.2013 *“Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”*, i ndryshuar;
- VKM nr. 945, datë 02.11.2012 *“Për miratimin e rregullores administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore”*, etj;
- VKM nr. 43, datë 15.1.2020 *“Për funksionimin e procesit të shkëmbimit të dokumenteve ndërmjet institucioneve, nëpërmjet sistemit të qarkullimit të dokumenteve me nënshkrim elektronik”*;
- Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”*, i ndryshuar;
- Udhëzimi nr. 1159, datë 17.03.2014 *“Për hartimin e Marrëveshjes të Nivelit të Shërbimit”*, i ndryshuar;
- Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI)
- Rregulloret përkatëse të Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI)
- Rregulloret përkatëse të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit;
- Aktet ligjore/nënligjore/rregullative që përcaktojnë regjistrimin dhe ruajtjen e të dhënave;
- Standardet e miratuara nga CESK, etj.
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t;
- Udhëzues dhe Manuale të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit si: ISSAI 5300, Manuali Aktiv i Auditimit TI si dhe Standardet e COBIT.

## **II.7. Standardet e auditimit:**

Auditimi është kryer, në përputhje me Kodin Etik, Standardet dhe teknikat e auditimit, duke përfshirë pyetësorë, intervista, testim dhe procedura, të cilat u gjykuan se ishin të nevojshme,

për të dhënë një vlerësim sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë, duke u fokusuar veçanërisht në standardet e fushës së auditimit të TIK, si: COBIT 4.1, Manuali i Auditimit IT, ISSAI 5310 si dhe standardet ndërkombëtare të teknologjisë së informacionit.

### **II.8. Metodat e auditimit:**

Grupi i auditimit, me qëllim arritjen e objektivave të auditimit, ka përdorur metoda si intervista me gojë zhvilluar në subjekt me personat përgjegjës, testime me zgjedhje, shqyrtimin e dokumentacionit rregullativ të institucionit, verifikimin e zbatimit të kontratave në varësi të rëndësisë dhe vlerës monetare, ka verifikuar dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar dhe të paraqitur nga subjekti i audituar me qëllim përmbushjen e drejttimeve të auditimit, ka testuar me teknikat CAAT të dhënat e sistemeve, si dhe ka kryer testime dhe verifikime mbi shkallën e sigurisë së rrjetit dhe sistemeve që subjekti i audituar përdor, analizimi i të dhënave të eksportuara nga sistemi, analizimi i të dhënave të raportuara nga ana e subjektit.

### **II.9. Dokumentimi i auditimit:**

Dokumentimi i auditimit është bazuar në rregulloren e procedurave të auditimit në KLSH si dhe në manualin e auditimit të teknologjisë së informacionit në të cilin janë përfshirë:

- Planifikimi, qëllimi dhe objektivat e auditimit;
- Programi i auditimit;
- Evidencat e grumbulluara në lidhje me të dhënat e sistemit, raporte të ndryshme me të dhëna nxjerrë nga sistemi;
- Letrat e punës mbajtur nga audituesit sipas detyrave të përcaktuara gjatë fazës së auditimit në terren;
- Pyetësorë dhe përgjigje të punonjësve që veprojnë nëpërmjet sistemit.

-Për çështjen e auditimit “*Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK*”, grupi i auditimit shqyrtoi dokumentacionin: Rregullorja e brendshme e institucionit; Struktura e përgjithshme organizative e miratuar e institucionit; Lista e të gjithë punonjësve në TI sipas kategorisë, hierarkisë, pozicionit të punës në strukturë si dhe përshkrimet e punës sipas akteve rregullative në fuqi; Organigrama; Aktet rregullative që lidhen me sistemet dhe veprimet operationale brenda dhe jashtë sistemit; Parimet dhe rregullat e përgjithshme të sigurisë së informacionit; Gjithashtu grupi i auditimit mblodhi informacione duke zhvilluar pyetësorë e intervista me stafin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial dhe mbi informacionin e mbledhur u zhvilluan analizime; etj.

-Për çështjen e auditimit “*Auditimi i Sigurisë së Informacionit*”, grupi i auditimit shqyrtoi dokumentacionin: Dokumentet e identifikimit të risqeve në TIK; Verifikime onsite të infrastrukturës së networku-t të institucionit; Skema e komunikimit të network-ut; Verifikimi i politikave mbi sigurinë e informacionit; Planet e menaxhimit të incidenteve; Konsultim me faqen e webit të ISHTI-t; etj.

-Për çështjen e auditimit “*Auditimi i zhvillimit dhe blerjes në teknologjinë e informacionit*”, grupi i auditimit shqyrtoi dokumentacionin: Lista e prokurimeve TIK të periudhës 01.01.2020 - 31.12.2022; Dosjet e procedurave të përcaktuara për auditim, sipas analizës së riskut; Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Shërbim mirëmbajtje për pajisje elektronike” e vitit 2020; “Shërbim mirëmbajtje për pajisje elektronike” e vitit 2021; “Bojra printeri, fotokopje, tonera”; DST e hartuar nga NJP për procedurat e përcaktuara për auditim; Sistemi elektronik i APP, sipas kodit të marrë nga APP si auditues, etj. Vlerësime nëse subjekti ka zhvilluar një procedura prokurimi konform udhëzimeve dhe ligjeve në fuqi, vlerësime nëse kërkesat e sigurisë janë adresuar në prokurime dhe janë në përputhje me to.

Për çështjen e auditimit “*Auditimi i Sistemeve*”, grupi i auditimit shqyrtoi dokumentacionin: Përshkrim i përgjithshëm i sistemit të teknologjisë së informacionit në ISHTI; Të dhënat e gjeneruara nga sistemi për shërbimet e ofruara; U mor akses me përdorues me të drejta “lexues”

në sistemin e-inspektimi; Aktet rregullative të inspektoratit që lidhen me sistemet dhe veprimet operacionale brenda dhe jashtë sistemit; Manualët e përdorimit të sistemit; Intervista të drejtpërdrejta me punonjësit; Të dhënat për përdoruesit e sistemit e-inspektimi; Analizë e performancës së sistemit; etj.

### III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

#### III.1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:



Veprimtaria e ISHTI-t, bazohet në: Ligjin nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 410, datë 13.05.2015, “Për krijimin, Organizimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial”, si dhe Urdhrin e Kryeministrit nr. 105, datë 13.03.2020, “Për Miratimin e Strukturës dhe Organikës së Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial”, i ndryshuar.

Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial është institucion publik buxhetor në varësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Detyrat, kompetencat dhe funksionet e tij të përgjithshme dhe të veçanta përcaktohen në Vendimin e

Këshillit të Ministrave nr. 410, datë 13.05.2015, “Për krijimin, organizimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial”.

Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial është strukturë përgjegjëse për inspektimin, për zbatimin dhe përmbushjen e kërkesave ligjore dhe nënligjore në fushën e:

- përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre, sipas legjislacionit përkatës;
- sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve elektrike, sipas legjislacionit përkatës;
- sigurisë së punës së instalimeve nën presion, si një linjë teknologjike e përbërë nga enë, tubacione dhe aksesore sigurie, që shërbejnë për mbajtjen, trajtimin dhe shpërndarjen e fluideve, sipas legjislacionit për sigurinë e enëve nën presion;
- sigurisë së punës në veprimtarinë e sektorit të gazit natyror, përfshirë transmetimin, shpërndarjen, depozitimin, si dhe ndërtimin e operimin e infrastrukturës së gazit natyror, sipas legjislacionit të sektorit të gazit natyror;
- sigurisë teknike të linjave teknologjike industriale të industrisë jo ushqimore, brenda fushës së përgjegjësisë së ministrisë përgjegjëse për industrinë, sipas legjislacionit përkatës;
- çdo përgjegjësi tjetër të përcaktuar me ligj apo akt nënligjor.

ISHTI ka për mision, të ndihmojë bizneset për përmirësimin e performancës së tyre për të përballuar sfidat në rritjen e cilësisë së produkteve që tregtojnë, në rritjen e vlerës ekonomike të produkteve hidrokarbure dhe shërbimeve të tjera që ofron ISHTI, nëpërmjet menaxhimit të cilësisë, sigurisë e shëndetit në punë, mjedis e kudo duke rritur efikasitetin e menaxhimit e rreziqeve.

#### III.2. PËRSHKRIMI I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT:

##### III.2.1. Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK

##### A. Strategjia, procedurat dhe rregulloret në TIK si dhe vlerësimi i burimeve njerëzore në TIK

*Objektivi:* Verifikimi nëse ekziston një strategji TI, e cila përfshin elementët TIK dhe proceset për zhvillimin, aprovimin, lidhur me objektivat e sektorit TIK në subjektin ISHTI. Auditimi nëse ekzistojnë strukturat, politikat dhe procedurat në strukturat IT që mundësojnë sektorin TIK në ISHTI të arrijë objektivat në funksion të plotësisë të misionit të saj. Përshkrimet e punës në këtë strukturë, ndarja e detyrave, zhvillimi i burimeve njerëzore.

### ➤ **Verifikimi i procedurave dhe burimeve njerëzore në TIK**

ISHTI është institucion qendror publik buxhetor në varësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Detyrat, kompetencat dhe funksionet e tij të përgjithshme dhe të veçanta përcaktohen në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 410, datë 13.05.2015, “Për krijimin, organizimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial”.

ISHTI është strukturë përgjegjëse për inspektimin, për zbatimin dhe përmbushjen e kërkesave ligjore dhe nënligjore në fushën e:

- a) përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre, sipas legjislacionit përkatës;
- b) sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve elektrike, sipas legjislacionit përkatës;
- c) sigurisë së punës së instalimeve nën presion, si një linjë teknologjike e përbërë nga enë, tubacione dhe aksesore sigurie, që shërbejnë për mbajtjen, trajtimin dhe shpërndarjen e fluideve, sipas legjislacionit për sigurinë e enëve nën presion;
- ç) sigurisë së punës në veprimtarinë e sektorit të gazit natyror, përfshirë transmetimin, shpërndarjen, depozitimin, si dhe ndërtimin e operimin e infrastrukturës së gazit natyror, sipas legjislacionit të sektorit të gazit natyror;
- d) sigurisë teknike të linjave teknologjike industriale të industrisë jo ushqimore, brenda fushës së përgjegjësisë së ministrisë përgjegjëse për industrinë, sipas legjislacionit përkatës;
- dh) çdo përgjegjësi tjetër të përcaktuar me ligj apo akt nënligjor.

ISHTI ushtron juridiksionin e tij në të gjithë territorin e vendit dhe funksionon në bazë të strukturës së miratuar sipas Urdhrit të Kryeministrit nr. 105, datë 13.08.2020 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial”.

Struktura e ISHTI, është e përbërë nga:

- Kryeinspektori;
- Drejtorja e Analizës, Vlerësimit të Riskut dhe Monitorimit;
- Drejtorja e Laboratorit Qendror;
- Drejtorja e Inspektimit të Pajisjeve nën Presion;
- Drejtorja e Inspektimit të Pajisjeve, Instalimeve Elektrike dhe Makineritë Ngritëse;
- Drejtorja e Inspektimit të Naftës, Gazit dhe nënprodukteve të tyre;
- Drejtorja e Sistemeve të Gazifikimit dhe Impianteve Kombëtare;
- Drejtorja e Informimit Publik dhe Koordinimit Ndërinstitucional;
- Drejtorja e Çështjeve Juridike;
- Drejtorja e Buxhetit dhe Financës;
- Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme.

### ➤ **Strategjia, procedurat dhe rregulloret në TIK**

- Nga auditimi ka rezultuar se Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial nuk disponon një strategji institucionale si dhe po ashtu ISHTI nuk disponon as një strategji mbi teknologjinë e informacionit mungesa e të cilave sjell mangësi në vendosjen e prioriteteve të institucionit. Strategjia e TI përfaqëson lidhjen e përbashkët midis objektivave të Strategjisë së TI dhe atyre të strategjisë së institucionit. Objektivat e strategjisë së TI duhet të marrin parasysh nevojat e tashme dhe të ardhshme të biznesit, kapacitetin aktual të TI për të ofruar shërbime dhe kërkesat e burimeve. Strategjia duhet të marrë në konsideratë ekzistencën e infrastrukturës dhe arkitekturës së TI, investimeve, modelit të ofrimit, burimet duke përfshirë stafin, si dhe paraqitjen e strategjisë që integron këto elementë në një qasje të përbashkët për të mbështetur objektivat e institucionit

Mungesa e një plani strategjik institucional të lidhur edhe me teknologjinë e informacionit mbart riskun e keq adresimit të burimeve të nevojshme të cilat mund të mbështesin mbarëvajtjen e punës dhe arritjen e objektivave të institucionit.

Grupi i auditimit, me qëllim auditimin e nivelit të dokumentimit të politikave dhe procedurave në lidhje me teknologjinë e informacionit në ISHTI, verifikoi Rregulloren e Brendshme të institucionit si dhe udhëzime të tjera të brendshme. Auditimi për këtë çështje, pati në konsideratë risqet që vijnë nga mungesa e politikave dhe procedurave të shkruara si dhe nga praktikat me të cilat institucioni zhvillon aktivitetin e tij.


Aktualisht, institucioni e ushtron aktivitetin e tij mbështetur në rregulloren “Për organizmin, funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial”, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 288, datë 13.10.2020.

Nga auditimi u konstatua se: Rregullorja e brendshme institucionale nuk përputhet me veprimtarinë reale të ISHTI-t, pasi në rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të ISHTI-t nuk janë të përcaktuara detyrat dhe përgjegjësitë e gjithsecilit. Rregullorja fokusohet deri në nivelin e përcaktimit të rregullave të përgjithshme të strukturave dhe nuk përshkruan detyrat e strukturave të brendshme, si për shembull, çfarë detyrash dhe përgjegjësishë ka përgjegjësi i sektorit TIK, etj. Përshkrimet e detyrave të punonjësve të sektorit TIK gjendet në dosjen e tyre personale, pra përshkrimi i punës nuk i atashohet pozicionit të punës por punonjësit konkret, gjë e cila nuk është e reflektuar në rregulloren e brendshme të inspektoratit.

### ➤ **Burimet njerëzore në TIK**

ISHTI ka në strukturën e tij të miratuar një numër total prej 200 punonjësish. Struktura e teknologjisë së informacionit në këtë institucion është në nivel sektori. Për periudhën objekt auditimi Sektori i Teknologjisë së Informacionit dhe Sistemeve në ISHTI, është në varësi të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme, e cila ka në strukturë një Përgjegjës Sektori dhe tre specialistë.

**Figura nr.1:** Struktura e Sektorit të Teknologjisë së Informacionit



**Tabela nr. 1:** Struktura e Sektorit të Teknologjisë së Informacionit dhe Sistemeve Plan/Fakt

Nr.	Emërtimi	Numër v.2022	
		Plan	Fakt
<b>Sektor i Teknologjisë së Informacionit dhe Sistemeve</b>		1	1
1	Përgjegjës Sektori	1	1
2	Specialist	3	3

**Burimi:** ISHTI, përpunuar nga grupi i auditimit

Bazuar në VKM nr. 673, datë 22.11.2017, strukturat përgjegjëse TIK të institucioneve dhe organeve të administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, bëhen pjesë e strukturës së AKSHI-t. Punonjësit aktualë të njëjësive të teknologjisë së informacionit e të komunikimit (NJTIK), në përbërje të strukturave të institucioneve dhe organeve të administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, kalojnë tek AKSHI, brenda

datës 31.12.2017.

- Në kundërshtim me pikën 23 të VKM-së nr. 673, datë 22.11.2017, në të cilën citohet se: “Strukturat përgjegjëse TIK bëhen pjesë të strukturës së AKSHI-t. Punonjësit aktualë të njësive të teknologjisë së informacionit e të komunikimit (NJTIK), në përbërje të strukturave të institucioneve dhe organeve të administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, kalojnë tek AKSHI, brenda datës **31.12.2017** dhe do të trajtohen në bazë të përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për nëpunësit civil, në rastin e mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit, apo Kodit të Punës. AKSHI vendos në dispozicion të institucioneve të përmendura në shkronjën “i”, të pikës 6, personelin e mjaftueshëm dhe të certifikuar sipas legjislacionit në fuqi, për të mbajtur në funksion optimal sistemet të cilat nuk preken nga fusha e veprimit të këtij vendimi”, ISHTI nuk ka bërë kalimin e burimeve njerëzore në AKSHI.

Nga auditimi u konstatua se: Struktura IT e ISHTI akoma nuk ka kaluar si pjesë e strukturës së AKSHI-t sipas përcaktimeve dhe afateve të vendosur në VKM Nr. 673, datë 22.11.2017, “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar.

Bazuar në kërkesën e ardhur nga AKSHI me nr. 5485/2 prot datë 24.08.2022 dhe protokolluar në ISHTI me nr.7578 prot, datë, 29.08.2022 AKSHI ka kërkuar fillimin e procesit të kalimit të aseteve hardware dhe software që ISHTI disponon, por nuk ka kërkuar për burimet njerëzore të TIK. Nisur sa më sipër ISHTI ka kthyer përgjigje në lidhje me sa kërkohej nga AKSHI në shkresën e saj.

#### ➤ **Trajnimet**

Zhvillimi i trajnimeve ka një rëndësi të veçantë për menaxhimin e kapaciteteve njerëzore në institucion. Punonjësit të cilët kanë akses në sistemet e informacionit duhet të jenë të njohur me standardet e sigurisë dhe të gëzojnë aftësinë për zbatimin dhe implementimin e tyre gjatë aktivitetit që kryejnë. Është e nevojshme që të identifikohen nevojat e stafit për trajnime mbi teknologjinë e informacionit.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion si dhe nga komunikimet verbale me subjektin Inspektorati Shtetëror Teknik Industrial është konstatuar se specialistët e TI nuk kanë marrë trajnime për kualifikime profesionale brenda dhe jashtë vendit, gjatë periudhës objekt auditimi. Po ashtu, ka rezultuar se institucioni nuk ka një plan mbi trajnimin e stafit të TI në fusha specifike të cilat do të ndihmonin stafin në rritjen profesionale, certifikimin dhe kualifikimin e mëtejshëm të tyre.

- Nga auditimi nuk u administruan dokumentacione mbi propozimet përkatëse nga niveli menaxherial i ISHTI (ku përfshihet dhe drejtorja e burimeve njerëzore) për zhvillimin e trajnimeve. Nuk dokumentohet procesi i kërkesave, nevojave dhe analizimi i tyre për trajnim. Duke mos plotësuar kështu nevojat për trajnim mbi sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit.

*Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është mbajtur Aktkonstatimi nr. 1, datë 15.03.2023, protokolluar në ISHTI me shkresën nr. 07/1, datë 15.03.2023, si dhe është trajtuar në faqet 8-12 të Projektraportit të Auditimit mbi të cilin nuk janë paraqitur observacione.*

**1. Titulli i gjetjes:** Mungesa e strategjisë institucionale dhe e TI për ISHTI.

**Situata:** Nga auditimi u konstatua se, Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial nuk disponon një strategji institucionale, mungesa e të cilës sjell mangësi në vendosjen e prioritetëve të institucionit si dhe mungesën e pasqyrimin të objektivave të lidhura me burimet dhe instrumentet e nevojshme për matjen e tyre.

**Kriteri:** Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, standardet ndërkombëtare të TI dhe praktikat më të mira të fushës.



**Ndikimi/efekti:** Mungesa e një strategjie mbart riskun e keq adresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së institucionit.

**Shkaku:** Mos zbatimi i praktikave më të mira në zhvillimin dhe menaxhimin institucional.

**Rëndësia:** E lartë

**1.1.Rekomandimi:** Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë të marrin masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë institucionale ku të përfshihen edhe elementë të teknologjisë së informacionit, me qëllim identifikimin dhe zhvillimin e objektivave institucionale.

**2.Titulli i gjetjes:** ISHTI nuk ka përditësuar rregulloren mbi të cilën mbështet veprimtarinë e saj.

**Situata:** Rregullorja e brendshme institucionale nuk përputhet me veprimtarinë reale të ISHTI-t, pasi në rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të ISHTI-t nuk janë të përcaktuara detyrat dhe përgjegjësitë e gjithsecilit. Rregullorja fokusohet deri në nivelin e përcaktimit të rregullave të përgjithshme të strukturave dhe nuk përshkruan detyrat e strukturave të brendshme.

**Kriteri:** Pasqyrimi i detyrave, përgjegjësive dhe kompetencave të secilës strukturë.

**Ndikimi/efekti:** Mos arritje e efektivitetit dhe efikasitetit të objektivave institucionale.

**Shkaku:** Nuk janë marrë masat e nevojshme për hartimin dhe përcaktimin e përshkrimeve të punës për punonjësit e ISHTI.

**Rëndësia:** E lartë

**2.1.Rekomandimi:** Strukturat drejtuese në Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial të marrin masa për përditësimin e rregullores së brendshme, në të cilën të reflektohen dhe pasqyrohen ndryshimet institucionale strukturore, rregullat, detyrat si dhe përshkrimet e punës të të gjithë punonjësve të Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial.

**3.Titulli i gjetjes:** Mos kalimi i strukturave përgjegjëse TIK dhe aktiveve të sistemeve të informacionit tek AKSHI.

**Situata:** Nga auditimi u konstatua se ISHTI akoma nuk e ka përfunduar procesin e kalimit tek Agjencia e Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, të burimeve njerëzore si dhe dorëzimin e Infrastrukturës TIK ekzistuese nën administrimin dhe inventarin e ISHTI-t, së bashku me të drejtat dhe detyrimet juridiko-civile, sipas përcaktimeve dhe afateve të vendosura në VKM Nr. 673, datë 22.11.2017, “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar.

**Kriteri:** VKM Nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar, ndarja II Kompetencat, detyrat dhe përgjegjësitë e AKSHI-t, pika 5, shkronja dh, gj dhe j, si dhe pika 6, shkronja dh dhe shkronja i.

**Ndikimi/efekti:** Mos arritje e objektivave institucionale si pasojë e keq adresimit të përcaktimit të detyrave, kompetencave dhe përgjegjësive sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

**Shkaku:** Mos zbatimi i përcaktimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

**Rëndësia:** E lartë

**3.1.Rekomandimi:** Organet drejtuese në Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial të marrin masa për kalimin e strukturave përgjegjëse TIK si dhe kalimin e aktiveve të sistemeve të informacionit të ISHTI-t tek Agjencia e Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, së bashku me të drejtat dhe detyrimet juridiko-civile sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

### III.2.2. Auditimi i Sigurisë së Informacionit

Siguria e informacionit është bërë gjithnjë e më shumë e rëndësishme për institucionet, kjo vjen si pasojë e rritjes së kompleksitetit të kontrollit të aksesit dhe ruajtjes së konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë së të dhënave nga marrëdhëniet e rrjeteve publike me ato private dhe nga bashkëpërdorimi i burimeve të informacionit. Siguria e Informacionit mund të

përcaktohet si metoda e një sistemi për të mbrojtur informacionin dhe burimet e sistemeve në përputhje me kushtet e konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë.

Lidhur nga sa më sipër, çdo institucion publik shtetëror që ofron shërbime ndaj qytetarëve e ka si detyrim ndërtimin e programit të sigurisë së informacionit me elementët kyç të cilët janë: *“Mjedisi i sigurisë së informacionit, Vlerësimi i riskut, Politikat e sigurisë, Organizimi i sigurisë së TI, Menaxhimi i komunikimeve dhe operacioneve, Menaxhimi i aseteve, Siguria e burimeve njerëzore, Siguria fizike dhe mjedisore, Kontrolli i aksesit, Menaxhimi i incidenteve të sigurisë së TI”*.

#### **a. Identifikimi dhe adresimi i risqeve në TIK**

Regjistri i Riskut, përfaqëson një dokument të projektuar në formën e matricës monitoruese, në të cilin evidentohet informacion mbi riskun e identifikuar, riskun e qenësishëm (para kontrolleve) dhe riskun pas kontrolleve duke evidentuar gjithashtu nevojën për kontrolle të mëtejshme.

Menaxhimi i riskut TI është aplikimi i metodave të menaxhimit të riskut në teknologjinë e informacionit për të menaxhuar rrezikun e TI-së, pra: Rreziku i institucionit që lidhet me përdorimin, pronësinë, operimin, përfshirjen, ndikimin dhe adoptimin e TI në ISHTI.

-Nga administrimi i dokumentacionit se si ISHTI, identifikon dhe menaxhon risqet institucionale dhe risqet në teknologjinë e informacionit, u konstatua se ISHTI nuk disponon regjistër risqesh lidhur me teknologjinë e informacionit. Në regjistrin e riskut për vitin 2022 të institucionit të vendosur në dispozicion të grupit të auditimit, nuk rezultoi të jenë dokumentuar risqe të identifikuara mbi teknologjinë e informacionit për periudhën objekt auditimi, ku të përfshihen edhe risqet mbi IT dhe të mbulohen të gjithë aktivitetet duke përfshirë këtu risqet mbi sistemin e-inspektimi, proceset e menaxhimit të ndryshimit, etj. ISHTI nuk ka identifikuar dhe vlerësuar ngjarjet e mundshme që mund të kenë efekt negativ përse i përket arritjes së objektivave të inspektoratit. Nisur sa më sipër dhe mbështetur në nenin 11, pika 2, neni 12 pika 3/d si dhe nenet 19-21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*, i ndryshuar, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”*, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 21, datë 25.10.2016 *“Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”*, UMF nr. 16, datë 20.07.2016 *“Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”*, ISHTI nuk disponon regjistër risku ku të përfshiheshin edhe risqet që lidhen me teknologjinë e informacionit. Duke mos realizuar identifikimin e risqeve, inspektorati rrezikon që ngjarjet të përsëriten dhe mënyra dhe koha e zgjidhjes së tyre është e papërcaktuar duke rrezikuar mbarëvajtjen e punës.

#### **➤ Menaxhimi i incidenteve dhe problemeve**

Për periudhën e audituar, në mungesë të procedurave të shkruara, risqet menaxhohen mbi bazë ngjarjesh. Suporti dhe komunikimi i brendshëm institucional si dhe me IQ apo me AKSHI-n si dhe mbështetja teknike dhe logjike për operacionet TI që ndihmojnë mbarëvajtjen e strukturave të institucionit kryhen nëpërmjet nëpërmjet e-mail-ëve, komunikimeve me celular apo shkëmbimeve verbale. Nga auditimi u konstatua se institucioni nuk ka të dokumentuar një plan masash për identifikimin, trajtimin e gabimeve, problemeve dhe incidenteve që mund të ndodhin në infrastrukturën TI.

Mungesa e masave dhe mungesa e rregullores për trajtimin e incidenteve bën që ISHTI të mos identifikojë dhe menaxhojë risqet me efekt negativ në TI dhe në proceset e punës si dhe sjell mos dokumentim të trajtimit të gabimeve ose incidenteve nga punonjësit e TI.

## **b. Verifikimi i shkallës së sigurisë fizike dhe aksesit në rrjet**

Meqenëse për periudhën nën auditim (01.01.2020-31.12.2022) sipas përcaktimeve të VKM 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar, AKSHI është institucioni përgjegjës për sistemet, infrastrukturën hardware dhe software, koordinimin e bazës së të dhënave, menaxhimin e strukturës TIK etj. Referuar VKM Nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit”, i ndryshuar, në ndarjen IV, “Dispozita kalimtare dhe të fundit”, në pikat e mëposhtme citohet se:

**18.** *Institucionet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave duhet të dorëzojnë pranë AKSHI-t 1 (një) kopje të dokumentacionit të plotë të çdo sistemi dhe infrastrukture TIK ekzistuese dhe kodin e burimit. Sistemet dhe infrastruktura TIK ekzistuese kalojnë nën administrimin dhe inventarin e AKSHI-t, së bashku me të drejtat dhe detyrimet juridiko-civile përkatëse brenda datës 30 shtator 2018.*

**19.** *Për sistemet dhe infrastrukturat TIK të cilat kalojnë në administrim dhe inventar të AKSHI-t dhe që zhvillohen ose mirëmbahen nëpërmjet marrëveshjeve ose kontratave të nënshkruara nga institucionet me palë të treta, të reflektohen ndryshimet përkatëse në këto akte.*

**20.** *Harton planin e transferimit nën administrimin e AKSHI-t të aseteve që preken nga fusha e veprimit të këtij vendimi.*

Nga auditimi u konstatua se ISHTI nuk ka në administrim asnjë sistem software-ik dhe nuk ka në përdorim apo administrim të tij, regjistër apo bazë të dhënash. ISHTI gjatë ushtrimit të detyrave të tij funksionale është përdorues i sistemit “e-inspektimi” i cili është ndërtuar dhe implementuar nga Inspektorati Qendror. Gjithashtu ISHTI në funksion të përmbushjes së detyrave të tij përdor edhe platformat e tjera Qeveritare të mundësuar nga ASKHI, konkretisht:

- Portalin e-Albania;
- Platformën e bashkëqeverisjes;
- Sistemin e tatimeve;
- Sistemin e fiskalizimit;
- Sistemin e Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik (SQDNE);
- Sistemin HRMIS.

Në tabelën e mëposhtme janë specifikuar pajisje të infrastrukturës TIK të hostuara në ambientet e ISHTI-t, të cilat janë kryesisht infrastrukturë network:

<b>Nr.</b>	<b>Lloji i pajisjes</b>	<b>Marka</b>	<b>Modeli</b>	<b>Sasia (në copë)</b>
1	PatchPanel	TRENDnet	TCP-24C5E	1
2	Router	MikroTik	hAP lite	2
3	Router	MikroTik	Board 750	1
4	Switch	Data-Link	DES 1024D	1
5	PatchPanel	TRENDnet	TCP-16C5E	1
6	Router	MikroTik	hAP lite	1
7	Switch	TRENDnet	TE 100-S24	1
8	PatchPanel	TRENDnet	TCP-24C5E	1
9	Router	Netgear	R7000	1
10	Rack Kabin	Mirsan	19 Cabin System	1
11	Centrali	Panasonic	KX-TDA600	1
12	Router	Huawei	HG8546M	1
13	PatchPanel	TRENDnet	TCP-24C5E	1
14	PatchPanel	TRENDnet	TCP-16C5E	6

15	Kamera	HikVision	DS-7108HQI-F1/N	1
16	Kamera	ALHUA	DHI-XVR5104HS-S2	1

Nga auditimi u konstatua se ISHTI akoma nuk e ka përfunduar procesin e dorëzimit të Infrastrukturës TIK ekzistuese nën administrimin dhe inventarin e ISHTI-t, së bashku me të drejtat dhe detyrimet juridiko-civile sipas përcaktimeve dhe afateve të vendosura në VKM Nr. 673, datë 22.11.2017, “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar. Megjithëse duhet të përmendim se përgjatë fazës së zhvillimit të auditimit në terren në këtë subjekt, institucionet (AKSHI dhe ISHTI) kanë filluar procesin e komunikimit dhe ndërveprimit për kalimin e infrastrukturës hardware pranë AKSHI-t.

➤ **Ambienti fizik ku ndodhet rack-u i infrastrukturës network**

Auditimi mbi shkallën e sigurisë së dhomës së serverave, u krye në bazë të manualit të auditimit TI, ISSAI 5310 dhe ISO 27001 si dhe rregullores për ndërtimin e dhomës së serverëve (*versioni 1.0, datë 02.12.2008*) miratuar nga AKSHI, që parashikon përcaktimin e standardeve të TIK për administratën publike.


Duke qenë se dhoma e serverëve është pika më delikate e një sistemi informatik dhe përqendrimi i pajisjeve kompjuterike, mekanike, elektrike dhe elektronike është më i lartë se në ambientet e tjera të punës, dëmet eventuale të shkaktuara në këtë ambient do të sillnin probleme serioze në funksionimin e të gjithë sistemit.

Në lidhje me sa më sipër, grupi i auditimit, të shoqëruar nga personat përgjegjës të sektorit të IT-së, verifikoi infrastrukturën hardware dhe network që disponon ISHTI. Nga auditimi u konstatua se ISHTI nuk disponon një dhomë serverësh të mirëfilltë pasi nuk ka sisteme dhe infrastrukturë serverësh të tijën.

Në ambientet e magazinës së ISHTI-t në katin e parë të godinës është lokalizuar një rack, në të cilin janë instaluar kryesisht infrastrukturë network si patch panel, switch, router, DVR për kamerat e sigurisë si dhe është hostuar edhe pajisja e një centrali telefonik të vogël që ISHTI e ka disponuar edhe më përpara periudhës së auditimit.

Nga auditimi u konstatua se ambienti ku është lokalizuar rack-u që përmban infrastrukturën network routerat, switch, etj, nuk përmbush kushtet standarde të përcaktuara në Rregulloren për ndërtimin e dhomës së serverëve (*Versioni 1.0, datë 02.12.2008*) miratuar nga AKSHI (Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit).

**Figura nr.1:** Pamjet e mëposhtme tregojnë gjendjen e rack-ut dhe infrastrukturës network në ISHTI





**Burimi:** Grupi i Auditimit

➤ ***Kontrollat e aksesit, politikat e sigurisë, menaxhimi i privilegjeve, përdorimi i infrastrukturës TIK në krijimin e kushteve optimale në ISHTI***

Në një mjedis shtetëror, kontrolli i aksesit është i rëndësishëm sepse shumë subjekte publike përpunojnë të dhëna sensitive dhe çështjet e privatësisë limitojnë se cilët persona duhet të shohin pjesë të ndryshme të informacionit.

Politikat e aksesit japin një bazë për kontrollin e ndërhyrjes ndaj informacioneve të institucionit. Funkzioni i Sigurisë së Informacionit monitoron efektivitetin e kontrollit të operacioneve të menaxhimit të llogarive të përdoruesve në kohë dhe raporton efikasitetin dhe efektivitetin e operimit.

Politikat e sigurisë së informacionit duhet të mbulojnë të gjithë risqet operacionale dhe të mbrojnë në mënyrë të arsyeshme të gjithë asetet e informacioneve kritike kundrejt humbjeve, dëmtimit dhe abuzimit. Nisur sa më sipër objektivat që duhet të arrijë subjekti janë:

Të sigurohet që vetëm përdoruesit e autorizuar ndaj informacioneve të kenë akses, si dhe A është efektiv dhe i sigurt procesi për ofrimin e kontrollit të aksesit ndaj punonjësve dhe personave të jashtëm që ushtrojnë aktivitetet në ambientet e ISHTI?

*Nga auditimi u konstatua se:*

-Hyrja kryesore në godinën e ISHTI-t është e kontrolluar nga një sistem aksesi për hyrje-daljet e punonjësve të ISHTI-t por sistemi i ngritur përgjithësisht nuk përdoret nga stafi me qëllim monitorimin e lëvizjeve dhe hyrje daljeve, gjë e cila kompromenton nivelin e sigurisë së aksesit në ambientet fizike të ISHTI-t, duke qenë se në këtë godinë ndodhen dhe laboratorët e ndryshëm për kryerjen e analizave të produkteve dhe nënprodukte të naftës.

➤ ***Mbi përdorimin e infrastrukturës TIK në krijimin e kushteve optimale në ISHTI u konstatua se:***

Shërbimet që ofron teknologjia e informacionit në ISHTI mbështetet në një infrastrukturë IT jo të konsoliduar dhe në disa pjesë është e amortizuar duke ndikuar negativisht dhe në shërbimet e ngritura mbi këtë rrjet.



ISHTI megjithëse është integruar në rrjetin GOVnet, siguria e informacionit mbart risqe që vijnë për shkak se sistemet e operimit apo programet e instaluar në kompjuterat dhe pajisjet pc të ISHTI-t nuk janë të gjitha të licencuara dhe nuk kanë versionet të përditësuara si dhe nuk përdorin për mbrojtje antivirus si dhe kryesisht pajisjet kompjuterike janë të dhuruara dhe nuk kanë të përditësuara sistemet e sigurisë, konkretisht:

- Pajisjet Pc kanë parametra minimale specifike dhe përgjithësisht kanë të instaluar sistemin operativ “Windows 7”, sistem për të cilin edhe vetë “Microsoft” që është prodhuesi i tij e ka ndërprere suportin për sistemin dhe nuk e rekomandon përdorimin e tij në vijimësi, duke i bërë pc-të e punonjësve dhe rrjetin network të ISHTI-t vulnerabël ndaj sulmeve dashakeqe.

- Pajisjet Pc nuk kanë të instaluar software Antivirus;

- Sistemet e operimit apo edhe software-t (si Office) e instaluar nëpër pc janë të pa licencuara;  
-Pajisjes periferike si printera janë kryesisht modele të vjetra por edhe të amortizuara, ku në të shumtën e rasteve, vështirë të gjendet bojë, pasi janë me bojra me rezervuar të lëngshëm ose “ink cartridge”.

*Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është mbajtur Aktkonstatimi nr. 2, datë 15.03.2023, protokolluar në ISHTI me shkresën nr. 07/3, datë 15.03.2023, si dhe është trajtuar në faqet 12-18 të Projektraportit të Auditimit mbi të cilin nuk janë paraqitur observacione.*

**1.Titulli i gjetjes:** Identifikimi i risqeve në teknologjinë e informacionit.

**Situata:** Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial nuk disponon regjistër risku ku të përfshiheshin edhe risqet që lidhen me teknologjinë e informacionit. Duke mos realizuar identifikimin e risqeve, inspektorati rrezikon që ngjarjet të përsëriten dhe mënyra dhe koha e zgjidhjes së tyre është e papërcaktuar duke rrezikuar mbarëvajtjen e punës. Gjithashtu institucioni nuk ka të dokumentuar një plan masash për identifikimin, trajtimin e gabimeve, problemeve dhe incidenteve që mund të ndodhin në infrastrukturën TI.

**Kriteri:** Përcaktimi dhe dokumentimi i planeve të veprimit. Neni 11, pika 2, neni 12 pika 3/d dhe nenet 19-21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar.

**Ndikim/Efekti:** Mos identifikim, mos adresim i problematikave që mund të shfaqen, shkelje e sigurisë.

**Shkaku:** Mos përmbushje e dispozitave ligjore.

**Rëndësia:** E Lartë

**1.1.Rekomandimi:** Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial të marrë masa për identifikimin dhe analizimin e risqeve për Teknologjinë e Informacionit me qëllim analizimin dhe vlerësimin e risqeve dhe përmbushjen e objektivave të institucionit. Gjithashtu të marrin masa për hartimin e një plan veprimi për identifikimin, raportimin, trajtimin dhe dokumentimin e incidenteve.

**2.Titulli i gjetjes:** Infrastruktura network e ISHTI nuk plotëson standardet më të mira të përcaktuara.

**Situata:** Nga auditimi u konstatua se ambienti ku është lokalizuar rack-u që përmban infrastrukturën network routerat, swich, etj, nuk përmbush kushtet standarde të përcaktuara në Rregulloren për ndërtimin e dhomës së serverëve (Versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI.

**Kriteri:** Infrastruktura të jetë e standardizuar sipas praktikave më të mira, Operacionet e rrjetit menaxhohen dhe kryhen në mënyrë të sigurtë dhe efektive. (Ref. ISO-27002, S15-IT control (Standardet e ISACA-s), COBIT).

**Ndikim/Efekti:** Mos garantim i vazhdimësisë së punës, risk për thyerje të sigurisë. Risk në mbarëvajtjen dhe ndërprerjen e punës duke ndikuar në performancën e sistemit.

**Shkaku:** Mos zbatimit i praktikave më të mira në ngritjen dhe menaxhimin e infrastrukturës network. Mungesa e mirëadministrimit dhe mungesa e investimeve.

**Rëndësia:** E Lartë.

**2.1.Rekomandim:** Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë të marrin masa për përmirësimin dhe standartizimin e infrastrukturës network me qëllim sigurimin e kushteve optimale për ofrimin e shërbimit dhe mbarëvajtjen e punës pa ndërprerje.

**3.Titulli i gjetjes:** Mospërdorimi i sistemit të kontrollit të hyrje-daljeve.

**Situata:** Hyrja kryesore në godinën e ISHTI-t është e kontrolluar nga një sistem aksesi për hyrje-daljet e punonjësve të ISHTI-t por sistemi i ngritur përgjithësisht nuk përdoret nga stafi me qëllim monitorimin e lëvizjeve dhe hyrje daljeve, gjë e cila kompromenton nivelin e sigurisë së aksesit në ambientet fizike të ISHTI-t, duke qenë se në këtë godinë ndodhen dhe laboratorët e ndryshëm për kryerjen e analizave të produkteve dhe nënprodukte të naftës.

**Kriteri:** Infrastruktura të jetë e standardizuar sipas praktikave më të mira, Operacionet e rrjetit menaxhohen dhe kryhen në mënyrë të sigurtë dhe efektive. (Ref. ISO-27002, S15-IT control (Standardet e ISACA-s), COBIT).

**Ndikim/Efekti:** Mos garantim i vazhdimësisë së punës, risk për thyerje të sigurisë.

**Shkaku:** Mos zbatimit i praktikave më të mira në ngritjen dhe menaxhimin e infrastrukturës fizike.

**Rëndësia:** E mesme.

**3.1.Rekomandim:** Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial të marrë masa për përdorimin dhe monitorimin e sistemit të aksesit hyrje-dalje nga i gjithë stafi i institucionit me qëllim rritjen e sigurisë në ambientet fizike të ISHTI.

**4.Titulli i gjetjes:** Infrastruktura TIK në ISHTI nuk plotëson kushtet e nevojshme optimale për administratën e ISHTI.

**Situata:** Shërbimet që ofron teknologjia e informacionit në ISHTI mbështetet në një infrastrukturë IT jo të konsoliduar dhe në disa pjesë është e amortizuar, konkretisht:

- Pajisjet Pc kanë parametra minimale specifike dhe përgjithësisht kanë të instaluar sistemin operativ “Windows 7”, sistem për të cilin edhe vetë “Microsoft” që është prodhuesi i tij e ka ndërprere suportin për sistemin dhe nuk e rekomandon përdorimin e tij në vijimësi, duke i bërë pc-të e punonjësve dhe rrjetin network të ISHTI-t vulnerabël ndaj sulmeve dashakeqe.

- Pajisjet Pc nuk kanë të instaluar software Antivirus;

- Sistemet e operimit apo edhe software-t (si Office) e instaluar nëpër pc janë të pa licencuara;

-Pajisjes periferike si printerat janë kryesisht modele të vjetra por edhe të amortizuara, ku në të shumtën e rasteve, vështirë të gjendet bojë, pasi janë me bojra me rezervuar të lëngshëm ose “ink cartridge”.

**Kriteri:** Infrastruktura TIK sipas praktikave më të mira. Standardizimi i veprimeve për zgjidhjen e problemeve dhe dokumentimi i tyre.

**Ndikimi/efekti:** Mos garantim i vazhdimësisë së punës, risk për thyerje të sigurisë.

**Shkaku:** Mos zbatimit i praktikave më të mira në ngritjen dhe menaxhimin e infrastrukturës network. Mungesa e mirëadministrimit dhe mungesa e investimeve.

**Rëndësia:** E Lartë.

**4.1.Rekomandimi:** Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë të marrë masa për përmirësimin, pajisjen dhe standartizimin e infrastrukturës TIK për punonjësit e administratës së ISHTI, me qëllim krijimin e kushteve optimale për përmbushjen e detyrave gjatë veprimtarisë së punës dhe mbarëvajtjen e punës pa ndërprerje.

### III.2.3. Auditimi i zhvillimit dhe blerjes në teknologjinë e informacionit

#### A.Procedurat e investimeve në fushën TIK

Për periudhën objekt auditimi 2020-2022, Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial ka realizuar në total 40 procedura prokurimi, me vlerë 31,628,682.24 lekë pa TVSH, nga të cilat vetëm 5 procedura prokurimi janë investime në TI me një vlerë totale 791,500.00 lekë pa TVSH. Përkatësisht, për vitin 2020 janë realizuar 2 procedura prokurimi me vlerë totale 172,500 lekë pa TVSH, ku njëra nga procedurat është me objekt shërbim mirëmbajtje dhe procedura tjetër kancelari. Për vitin 2021, janë realizuar 3 procedura prokurimi për TI me vlerë totale 619,000 lekë pa TVSH, ku përfshihen një procedurë me objekt shërbim mirëmbajtje, një blerje mallrash dhe një kancelari. Ndërsa për vitin 2022, Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial nuk ka realizuar asnjë procedurë prokurimi me objekt TI.

Nga auditimi mbi regjistrin e procedurave të prokurimit realizuar për vitet 2020 - 2022 rezultoi se ISHTI, ka zhvilluar afërsisht 3 procedura prokurimi me vlerë të vogël që lidhen me shërbime dhe mallra në teknologjinë e informacionit me vlerë kontrate afërsisht 304,500 lekë (pa tvsh) dhe me fond limit 866,713 lekë (pa tvsh).

- Grupi i auditimit shqyrtoi regjistrat e parashikimeve dhe të realizimeve të prokurimit publik nga i cili rezultoi se vlera e fondit limit në regjistrat e realizimeve në Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial nuk rakordojnë me vlerat reale të procedurave të prokurimit. Nga dokumentet shkresore si dhe nga komunikimi verbal me personat përgjegjës në institucion, rezultoi se kjo ka ardhur si pasojë e mos përditësimit të të dhënave ashtu siç parashikohet edhe në dispozitat ligjore në nenin 3 dhe 4 të VKM nr. 285 mbi regjistrin e parashikimeve dhe të realizimeve.

Më poshtë janë pasqyruar në formë tabelare regjistri i realizimeve dhe regjistri i parashikimeve për vitet 2020-2021 në ISHTI:

**Tabela nr.1:** Regjistri i parashikimeve ISHTI 2020-2021

Nr.	Objekti i Prokurimit	Tipi i kontratës	Fondi i përlogaritur	Vlera
1	Shërbim mirembajtje për pajisje elektronike	Shërbime	190000.00	190000.00
2	Bojra printeri, fotokopje, tonera	Mallra	740000.00	740000.00
3	Shërbim mirembajtje për pajisje elektronike	Shërbime	190000.00	190000.00

**Burimi:** Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial. Punoi Grupi i Auditimit

**Tabela nr.2:** Regjistri i realizimeve ISHTI 2020-2021

Nr.	Objekti i Prokurimit	Fondi Limit	Vlera e kontratës	Operatori Ekonomik i shpallur fitues	Viti i realizimit të procedurës së prokurimit
1	Shërbim mirembajtje për pajisje elektronike	190000.00	132500.00	C.R.C	2020
2	Bojra printeri, fotokopje, tonera	740000.00	111000.00	I.O	2021
3	Shërbim mirembajtje për pajisje elektronike	190000.00	61000.00	C.	2021

**Burimi:** Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial. Punoi Grupi i Auditimit

-Janë audituar 3 procedura prokurimi të renditura si më poshtë:

**I. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Shërbim mirëmbajtje për pajisje elektronike”**



Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

1. Urdhër Prokurimi: Nr. 5819 Prot., datë 16.10.2020	3. Hartuesit e specifikimeve teknike: K.K E.Gj E.Sh	4. Komisioni i llogaritjes se fondit limit: K.K E.Gj E.Sh
2. Fondi Limit (pa tvsh) 140,867 lekë		
5. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë prokurimi me vlerë të vogël”	6. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: K.K E.Gj E.Sh	7. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: K.K E.Gj E.Sh
8. Data e hapjes së tenderit: <b>20.10.2020</b>	9. Operatori fitues: “C.R.C” Vlera e ofertës fituese, pa TVSH, 132,500 lekë	10. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 8,367 lekë
11.Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender: 17 (shtatëmbëdhjetë)	12. Operatore te Kualifikuar: 6 (gjashtë)	13. Operatorë të skualifikuar: 11 (njëmbëdhjetë)
14. Ankimimet: -	15. Përgjigje Ankesës nga AK -	16. Përgjigje Ankesës nga KPP: -
17. Marrja në Dorëzim Datë 02.11.2020	18. Vlera e kontratës (me tvsh): 159,000 lekë	19. Afati i kontratës: 2 Ditë

**-Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit të kontratave:** Specifikimet teknike të mallrave për këtë procedurë prokurimi në përgjithësi janë hartuar në zbatim të nenit 36 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në nenin 27 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Gjithashtu, edhe në përlogaritjen e vlerës limit të kontratës përgjithësisht janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në nenin 40 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

**-Hartimi i dokumenteve të tenderit:** Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe dokumenteve standarde për kontratat e punës, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po ashtu, janë hartuar dhe vendosur në dokumentacion përveç kriterëve ligjore të përgjithshme të pranimit kualifikimit edhe kriteret e veçanta kualifikuese.

**-Përzgjedhja e operatorit fitues:** Në tenderin e zhvilluar kanë marrë pjesë 14 operatorë ekonomik. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka shqyrtuar dokumentacionin e operatorëve pjesëmarrës dhe ka bërë këtë klasifikim:

Operatorët Ekonomikë të kualifikuar		Operatorët Ekonomikë të Skualifikuar	
A.	94,000.00	B.I.S.S.	
E.H	94,000.00	O.H	
E.	95,000.00	E.Sh	
T.E	95,600.00	X.S	
C.R.C	132,500.00	E.I	
R.	135,000.00	O.T	
		T.I	
		J.G	
		A.K.M	
		A.D	
		A.A	

**Burimi:** Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial. Punoi Grupi i Auditimit

- Operatori ekonomik: “T.E” është skualifikuar nga procedura e prokurimit për shkak të njoftimit për tërheqjen e OE me arsyetimin se nuk mund të realizonin punën brenda afatit dy ditor. Në këto kushte KVO e ka skualifikuar ofertën e OE.

- Operatori ekonomik: “C.R.C” i ka plotësuar të gjitha kriteret e DT dhe pas tërheqjes së OE të tjerë, KVO e ka pranuar kërkesën e këtij operatori ekonomik duke e shpallur fitues të procedurës së prokurimit me vlerë të vogël.

**-Kryerja e shërbimit:** Me datë 02.11.2020 është mbajtur një procesverbal mbi kryerjen e shërbimit të mirëmbajtjes së pajisjeve elektronike nga komisioni i përbërë nga K.K, E.Sh dhe E.Gj.

#### **Zhvillimi i kontratës:**

- Me shkresën nr. 5474 Prot. Datë 02.10.2020, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme i ka dërguar një kërkesë për blerje Sektorit të Prokurimeve dhe Shërbimeve të Brendshme, në të cilën janë parashtruar nevojat e institucionit për shërbimin e mirëmbajtjes për pajisjet elektronike.

- Fondi limit i përlllogaritur nga ISHTI është në vlerën 140,867 lekë pa TVSH me procesverbalin e mbajtur më 15.10.2020, Ky procesverbal nuk është protokolluar nga institucioni.

Më 15.10.2020 komisioni i prokurimit mori tre oferta, si më poshtë:

K.S	92,500 lekë pa TVSH
F.C.K	170,200 lekë pa TVSH
C.R.C	159,900 lekë pa TVSH

**Burimi:** *Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial. Punoi Grupi i Auditimit*

Komisioni është i përbërë nga K.K, E.Gj dhe E.Sh. Ky komision është i njëjtë për specifikimet teknike, për përlllogaritjen e fondit limit si dhe për vlerësimin e ofertave. Asnjë nga anëtarët e komisionit nuk është ekspert i fushës, në kundërshtim me nenin 75/1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 parashikon se komisioni i vlerësimit të ofertave përbëhet nga jo më pak se tre persona, ku të paktën një prej anëtarëve është ekspert i fushës.

Me shkresën nr. 5818 Prot., datë 16.10.2020 Kryeinspektori ka miratuar relacionin argumentues mbi kryerjen e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Shërbim mirëmbajtje për pajisje elektronike”.

Titullari i Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial me shkresën nr. 5819, datë 16.10.2020 ka miratuar Urdhrin e prokurimit “Për prokurimin me vlerë të vogël, nr.12, datë 16.10.2020”. Me shkresën nr. 5819/1 Prot., datë 16.10.2020 Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial ka dërguar ftesën për ofertë ku ka përcaktuar specifikimet teknike si dhe afatet e kryerjes së shërbimit.

Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël në Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial, më 20.10.2020 ka mbajtur një procesverbal mbi skualifikimin e operatorëve ekonomikë për procedurën e prokurimit me objekt “Shërbim mirëmbajtje për pajisje elektronike”. 11 (njëmbëdhjetë) OE u skualifikuan për shkak të tejkalimit të fondit limit të përcaktuar nga ISHTI si dhe një nga ofertuesit nuk e ka në veprimtarinë e tij objektin e prokurimit.

- Më 28.10.2020 në ISHTI është mbajtur procesverbali mbi kalimin tek operatori ekonomik i radhës. OE “T.E” është skualifikuar nga procedura e prokurimit me arsyetimin se nuk mund të realizonin punën brenda afatit dy ditor. Ky procesverbal nuk është firmosur nga komisioni i prokurimit si dhe nuk është protokolluar nga ISHTI.

Titullari i Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial me shkresën nr. 6169, datë 02.11.2020 ka miratuar formularin e njoftimit të fituesit për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Shërbim mirëmbajtje për pajisje”. ISHTI ka shpallur fitues OE “C.R.C” me vlerë 132,500 lekë pa TVSH.

Më 02.11.2020 është mbajtur procesverbali mbi kryerjen e shërbimit të mirëmbajtjes së pajisjeve elektronike nga komisioni i përbërë nga K.K, E.Sh dhe EGj.

- Në dosjen e procedurës së prokurimit me objekt “Shërbim mirëmbajtje për pajisje” nuk është nënshkruar kontratë ndërmjet palëve, në kundërshtim me përcaktimet e parashikuara në nenin

15/2 të ligji nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” si dhe në nenin 85 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku parashikohet lidhja e kontratës si pjesë e dokumenteve të procedurës së prokurimit.

- Gjithashtu, në dosjen e procedurës së prokurimit nuk është hartuar raporti përmbledhës, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të parashikuara në nenin 99 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ku kërkohet që për çdo kontratë ose marrëveshje kuadër që mbulohet nga ligji, autoriteti kontraktor duhet të hartojë një raport me shkrim ku duhet të përfshijë të dhënat e AK, emrat e kandidatëve të kualifikuar dhe atyre të skualifikuar etj.

## **II- Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Bojra printeri, fotokopje, tonera”**

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

1. Urdhër Prokurimi: Nr. 3085/2 Prot., datë 04.06.2021	3. Hartuesit e specifikimeve teknike: K.K E.Gj E.Sh	4. Komisioni i llogaritjes se fondit limit: K.K E.Gj E.Sh
2. Fondi Limit (pa tvsh) 651,179 lekë		
5. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë prokurimi me vlerë të vogël”	6. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: K.K E.Gj E.Sh	7. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: K.K E.Gj E.Sh
8. Data e hapjes së tenderit: <b>08.06.2021</b>	9. Operatori fitues: “I.O” Vlera e ofertës fituese, pa TVSH, 111,000 lekë	10. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 540,179 lekë
11. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender: 32 (tridhjetë e dy)	12. Operatore të Kualifikuar: 27 (njëzet e shtatë)	13. Operatorë të skualifikuar: 5 (pesë)
14. Ankimimet: -	15. Përgjigje Ankesës nga AK -	16. Përgjigje Ankesës nga KPP: -
17. Marrja në Dorëzim Datë 16.06.2021	18. Vlera e kontratës (me tvsh): 133,200 lekë	19. Afati i kontratës: 2 Ditë

*Nga auditimi u konstatua:*

**-Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit të kontratave:** Specifikimet teknike të mallrave për këtë procedurë prokurimi në përgjithësi janë hartuar në zbatim të nenit 36 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Gjithashtu, edhe në përllogaritjen e vlerës së fondit limit të kontratës përgjithësisht janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në nenin 56 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

**-Hartimi i dokumenteve të tenderit:** Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe dokumenteve standarde për kontratat e punës, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po ashtu, janë hartuar dhe vendosur në dokumentacion përveç kritereve ligjore të përgjithshme të pranimit kualifikimit edhe kriteret e veçanta kualifikuese.

**-Përzgjedhja e operatorit fitues:** Në tenderin e zhvilluar kanë marrë pjesë 32 operatorë ekonomik. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka shqyrtuar dokumentacionin e operatorëve pjesëmarrës dhe ka bërë këtë klasifikim:

Operatorët Ekonomikë të kualifikuar		Operatorët Ekonomikë të skualifikuar
P.O	84,500.00	O.H
A.K.K	92,800.00	D.J
I.O	111,000.00	I.S
E.L	128,600.00	I.A.C
I.B	158,000.00	A.
B.S	169,800.00	
E.O	182,750.00	

A.	208,700.00	
A.H	217,400.00	
I.G.J.K	235,000.00	
A.	295,000.00	
E.Q	325,583.00	
R.	373,000.00	
L.D	377,777.00	
B.T	385,500.00	
C.	396,000.00	
P.S	469,000.00	
I.	499,990.00	
E.H	544,000.00	
O.T	583,333.00	
E.H	584,000.00	
B.	629,000.00	
E.	629,000.00	
J.G	633,333.00	
T.	649,000.00	
O.M.M	650,000.00	

**Burimi:** Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial. Punoi Grupi i Auditimit

- Operatori ekonomik: “P.O” është tërhequr nga procedura për shkak të llogaritjes gabim të fondit limit, në këto kushte KVO e ka skualifikuar ofertën e OE.

- Operatori ekonomik: “A.K” është tërhequr nga procedura për shkak të mos plotësimit të specifikimeve teknike të përcaktuara në ftesën për ofertë, si më poshtë:

1. Numri i faqeve i pavendosur në kutinë e tonerave;

2. Part-number/ kodi nuk ishte i specifikuar sipas tabelës në ftesën për ofertë.

Në këto kushte KVO e ka skualifikuar ofertën e OE.

- Operatori ekonomik: “I.O” i ka plotësuar të gjitha kriteret e DT dhe pas tërheqjes së OE të tjerë, KVO e ka pranuar kërkesën e këtij operatori ekonomik duke e shpallur fitues të procedurës së prokurimit me vlerë të vogël.

**-Marrja në dorëzim e pajisjeve dhe shërbimit:**

- Me Urdhrin nr. 3085/5, datë 16.06.2021 të Kryeinspektorit është ngritur komisioni për ndjekjen e zbatimit të kontratës dhe marrjen në dorëzim, të përbërë nga E.B, K.K dhe A.R.

- Me datë 16.06.2021 në Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial është mbajtur procesverbali i marrjes në dorëzim.

**Zhvillimi i kontratës:**

- Me shkresën nr. 3085 Prot. datë 04.06.2021, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme i ka dërguar një kërkesë për blerje Komisionit të blerjeve me vlera të vogla, në të cilën janë parashtruar nevojat e institucionit për tonera, printer dhe fotokopje me pretendimin se sasia e produkteve në magazinë ka qenë drejt përfundimit.

- Fondi limit i përlllogaritur nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial është në vlerën 651,179 lekë pa TVSH me shkresën nr. 3085/1 Prot. datë 04.06.2021.

Më 04.06.2021 komisioni i prokurimit mori tre oferta, si më poshtë:

I.O	555,156 lekë pa TVSH
S.S	699,000 lekë pa TVSH
I.P	701,000 lekë pa TVSH

**Burimi:** Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial. Punoi Grupi i Auditimit

- Komisioni është i përbërë nga K.K, E.Gj dhe E.Sh. Ky komision është i njëjtë për specifikimet teknike, për përlllogaritjen e fondit limit si dhe për vlerësimin e ofertave. Asnjë nga anëtarët e komisionit nuk është ekspert i fushës, në kundërshtim me nenin 75/1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 parashikon se komisioni i vlerësimit të ofertave përbëhet nga jo më pak se tre persona, ku të paktën një prej anëtarëve është ekspert i fushës.

Titullari i Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial me shkresën nr. 3085/2, datë 04.06.2021 ka miratuar Urdhrin e prokurimit “Për prokurimin me vlerë të vogël, nr.7, datë 04.06.2021”.

Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël në Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial, më 08.06.2021 ka mbajtur procesverbalin mbi skualifikimin e operatorëve ekonomikë për procedurën e prokurimit me objekt “Bojra printeri, fotokopje dhe tonera”. 5 (pesë) OE u skualifikuan për shkak të tejkalimit të fondit limit të përcaktuar nga ISHTI.

Më 09.06.2021 në ISHTI është mbajtur procesverbali mbi kalimin tek operatori ekonomik i radhës. OE “P.O” është skualifikuar nga procedura e prokurimit për shkak të njoftimit që ka bërë me arsyetimin se do tërhiqej sepse kishte bërë një përlllogaritje të gabuar të fondit limit. Më 11.06.2021 në ISHTI është mbajtur procesverbali mbi kalimin tek operatori ekonomik i radhës. OE “A.K” është skualifikuar nga procedura për shkak të njoftimit për tu tërhequr me arsyetimin e mos plotësimin të specifikimeve teknike të përcaktuara në ftesën për ofertë, si më poshtë:

1. Numri i faqeve i pavendosur në kutinë e tonerave;
2. Part-number/ kodi nuk ishte i specifikuar sipas tabelës në ftesën për ofertë.

Procesverbali është firmosur nga komisioni i prokurimit K.K, E.Gj dhe E.Sh si dhe nga dy specialistë IT, J.T dhe A.R.

- Procesverbali mbi kalimin tek operatori ekonomik i radhës i mbajtur me datë 09.06.2021 nuk është firmosur nga komisioni i prokurimit të përbërë nga K.K, E.Gj dhe E.Sh si dhe nuk është protokolluar nga ISHTI. Gjithashtu, edhe procesverbali i mbajtur në datë 11.06.2021 mbi kalimin tek operatori ekonomik i radhës nuk është protokolluar.

Titullari i Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial me shkresën nr. 3085/4, datë 16.06.2021 ka miratuar formularin e njoftimit të fituesit për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Bojra printeri, fotokopje, tonera”. ISHTI ka shpallur fitues OE “I.O” me vlerë 111,000 lekë pa TVSH.

Me Urdhrin nr. 3085/5, datë 16.06.2021 të Kryeinspektorit është ngritur komisioni për ndjekjen e zbatimit të kontratës dhe marrjen në dorëzim, të përbërë nga E.B, K.K dhe A.R.

- Me datë 16.06.2021 në Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial është mbajtur procesverbali i marrjes në dorëzim.

- Në dosjen e procedurës së prokurimit me objekt “Bojra printeri, fotokopje, tonera” nuk është hartuar raporti përmbledhës, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të parashikuara në nenin 99 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ku kërkohet që për çdo kontratë ose marrëveshje kuadër që mbulohet nga ligji, autoriteti kontraktor duhet të hartojë një raport me shkrim ku duhet të përfshijë të dhënat e AK, emrat e kandidatëve të kualifikuar dhe atyre të skualifikuar etj.

### **III. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Shërbim mirëmbajtje për pajisje elektronike”**

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

1. Urdhër Prokurimi: Nr. 8071/1 Prot., datë 09.12.2021	3. Hartuesit e specifikimeve teknike: E.H E.Gj E.Sh	4. Komisioni i llogaritjes se fondit limit: E.H E.Gj E.Sh
2. Fondi Limit (pa tvsh) 74,666.66 lekë		

5. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë prokurimi me vlerë të vogël”	6. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: E.H E.Gj E.Sh	7. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: E.H E.Gj E.Sh
8. Data e hapjes së tenderit: <b>13.12.2021</b>	9. Operatori fitues: “C.” Vlera e ofertës fituese, pa TVSH, 61,000 lekë	10. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 15,666.66 lekë
11. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender: 14 (katërmbëdhjetë)	12. Operatore te Kualifikuar: 5 (pesë)	13. Operatorë të skualifikuar: 9 (nëntë)
14. Ankimimet: -	15. Përgjigje Ankesës nga AK -	16. Përgjigje Ankesës nga KPP: -
17. Marrja në Dorëzim Datë 24.12.2021	18. Vlera e kontratës (me tvsh): 73,200 lekë	19. Afati i kontratës: 2 Ditë

**-Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit të kontratave:** Specifikimet teknike të mallrave për këtë procedurë prokurimi në përgjithësi janë hartuar në zbatim të nenit 36 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Gjithashtu, edhe në përlllogaritjen e vlerës së fondit limit të kontratës përgjithësisht janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në nenin 56 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

**-Hartimi i dokumenteve të tenderit:** Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe dokumenteve standarde për kontratat e punës, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po ashtu, janë hartuar dhe vendosur në dokumentacion përveç kritereve ligjore të përgjithshme të pranimit kualifikimit edhe kriteret e veçanta kualifikuese.

**-Përzgjedhja e operatorit fitues:** Në tenderin e zhvilluar kanë marrë pjesë 14 operatorë ekonomik. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka shqyrtuar dokumentacionin e operatorëve pjesëmarrës dhe ka bërë këtë klasifikim:

Operatorët Ekonomikë të kualifikuar		Operatorët Ekonomikë të Skualifikuar
A.	53,000.00	O.H
R.	57,000.00	M.N
I.B.S	60,000.00	G.D
C.	61,000.00	A.A
O.T	66,667.00	B.T
		J.
		E.H
		I.C
		A.

**Burimi:** Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial. Punoi Grupi i Auditimit

- Operatori ekonomik: “A.” është skualifikuar nga procedura e prokurimit për shkak të mos paraqitjes së dokumentacionit të kërkuar brenda afatit kohor prej 24 orësh siç ishte përcaktuar në ftesën për ofertë. Në këto kushte KVO e ka skualifikuar ofertën e OE.

- Operatori ekonomik: “R.” është skualifikuar nga procedura për shkak të njoftimit për tu tërhequr me arsyetimin e përlllogaritjes gabim të fondit limit. Në këto kushte KVO e ka skualifikuar ofertën e OE.

- Operatori ekonomik: “I.B.S” është skualifikuar nga procedura për shkak të njoftimit për tu tërhequr me arsyetimin e përlllogaritjes gabim të fondit limit. Në këto kushte KVO e ka skualifikuar ofertën e OE.

- Operatori ekonomik: “C.” i ka plotësuar të gjitha kriteret e DT dhe pas tërheqjes së OE të tjerë, KVO e ka pranuar kërkesën e këtij operatori ekonomik duke e shpallur fitues të procedurës së prokurimit me vlerë të vogël.



**-Kryerja e shërbimit:** Me shkresën nr. 8071/4, datë 24.12.2021 të Kryeinspektorit është mbajtur një procesverbal mbi kryerjen e shërbimit të mirëmbajtjes së pajisjeve elektronike nga komisioni i përbërë nga E.H, E.Sh dhe J.T.

**Zhvillimi i kontratës:**

- Me shkresën nr. 6489 Prot. datë 13.10.2021, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme i ka dërguar një kërkesë për blerje Komisionit të blerjeve me vlera të vogla, në të cilën janë parashtruar nevojat e institucionit për shërbimin e mirëmbajtjes për pajisjet elektronike. Me shkresën nr. 8071, datë 09.12.2021 Kryeinspektori ka miratuar relacionin argumentues mbi kryerjen e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Shërbim mirëmbajtje për pajisje elektronike”.

- Fondi limit i përlllogaritur nga ISHTI është në vlerën 76,666.66 lekë pa TVSH me procesverbalin e mbajtur më 09.12.2021, Ky procesverbal nuk është protokolluar nga institucioni.

Më 09.12.2021 komisioni i prokurimit mori tre oferta, si më poshtë:

R.T	55,000 lekë pa TVSH
A.P	67,500 lekë pa TVSH
A.	101,500 lekë pa TVSH

**Burimi:** Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial. Punoi Grupi i Auditimit

Komisioni është i përbërë nga E.H, E.Gj dhe E.Sh. Ky komision është i njëjtë për specifikimet teknike, për përlllogaritjen e fondit limit si dhe për vlerësimin e ofertave. Asnjë nga anëtarët e komisionit nuk është ekspert i fushës, në kundërshtim me nenin 75/1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 parashikon se komisioni i vlerësimit të ofertave përbëhet nga jo më pak se tre persona, ku të paktën një prej anëtarëve është ekspert i fushës.

Titullari i Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial me shkresën nr. 8071/1, datë 09.12.2021 ka miratuar Urdhrin e prokurimit “Për prokurimin me vlerë të vogël, nr. 22, datë 09.12.2021”.

Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël në Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial, më 13.12.2021 ka mbajtur një procesverbal mbi skualifikimin e operatorëve ekonomikë për procedurën e prokurimit me objekt “Shërbim mirëmbajtje për pajisje elektronike”. 9 (nëntë) OE u skualifikuan për shkak të tejkalimit të fondit limit të përcaktuar nga ISHTI.

Më 14.12.2021 në ISHTI është mbajtur procesverbali mbi kalimin tek operatori ekonomik i radhës. OE “A.” është skualifikuar nga procedura e prokurimit për shkak të mos paraqitjes së dokumentacionit të kërkuar brenda afatit kohor prej 24 orësh siç ishte përcaktuar në ftesën për ofertë.

Më 15.12.2021 në ISHTI është mbajtur procesverbali mbi kalimin tek operatori ekonomik i radhës. OE “R.” është skualifikuar nga procedura për shkak të njoftimit për tu tërhequr me arsyetimin e përlllogaritjes gabim të fondit limit.

Më 20.12.2021 në ISHTI është mbajtur procesverbali mbi kalimin tek operatori ekonomik i radhës. OE “I.B.S” është skualifikuar nga procedura për shkak të njoftimit për tu tërhequr me arsyetimin e përlllogaritjes gabim të fondit limit.

- Procesverbalet e përmendura më sipër janë firmosur nga komisioni i prokurimit por nuk janë protokolluara.

Titullari i Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial me shkresën nr. 8071/3, datë 23.12.2021 ka miratuar formularin e njoftimit të fituesit për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Shërbim mirëmbajtje për pajisje”. ISHTI ka shpallur fitues OE “C.” me vlerë 61,000.00 lekë pa TVSH.

Me shkresën nr. 8071/4, datë 24.12.2021 të Kryeinspektorit është mbajtur një procesverbal mbi kryerjen e shërbimit të mirëmbajtjes së pajisjeve elektronike nga komisioni i përbërë nga E.H, E.Sh dhe J.T.

- Në dosjen e procedurës së prokurimit me objekt “Shërbim mirëmbajtje për pajisje” nuk është nënshkruar kontratë ndërmjet palëve, në kundërshtim me përcaktimet e parashikuara në nenin 15/2 të ligji nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” si dhe në nenin 85 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku parashikohet lidhja e kontratës si pjesë e dokumenteve të procedurës së prokurimit.

- Gjithashtu, në dosjen e procedurës së prokurimit nuk është hartuar raporti përmbledhës, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të parashikuara në nenin 99 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ku kërkohet që për çdo kontratë ose marrëveshje kuadër që mbulohet nga ligji, autoriteti kontraktor duhet të hartojë një raport me shkrim ku duhet të përfshijë të dhënat e AK, emrat e kandidatëve të kualifikuar dhe atyre të skualifikuar etj.

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është mbajtur Aktkonstatimi nr. 3, datë 15.03.2023, protokolluar në ISHTI me shkresën nr. 07/4 datë 15.03.2023, si dhe është trajtuar në Projektraportin e Auditimit (faqe 19-29) mbi të cilin janë paraqitur observacione me shkresën nr. 2500/2 Prot., datë 19.04.2023 nga ISHTI, protokolluar në KLSH me nr. 1189/3 Prot., datë 24.04.2023.

*Meqenëse observacionet janë formuluar bazuar në të njëjtin pretendim mbi gjetjet, ato janë trajtuar bazuar në të njëjtën përgjigje, si më poshtë:*

*Pretendimi subjektiv: ... Në asnjë rast as ligjet, as VKM-t dhe as udhëzimet e sipërcituara, mbi bazën dhe në respekt të të cilave janë hartuar regjistrat e mësipërm nuk parashikojnë dhe nuk kërkojnë rakordim vlerash.*

***Qëndrimi i grupit të auditimit:*** *Sqarojmë se, ISHTI duhet të kishte marrë masa për të bërë ndryshimet e nevojshme bazuar në nenin 3 dhe 4 të VKM nr. 285. Në nenin 3, pika 7 të VKM 285, datë 19.5.2021, thuhet se: “Autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të bëjë ndryshime në regjistrin e parashikimeve të procedurave të prokurimit, vetëm në raste kur këto ndryshime vijnë për arsye që nuk kanë qenë të mundura të parashikohen në kohën e hartimit të regjistrit”. Në zbatim të dispozitave ligjore mbi prokurimin publik vlerat në regjistrin e parashikimeve dhe realizimeve duhet të jenë vlerat reale të cilat janë përdorur për realizimin e një procedure prokurimi. Për sa më lart, grupi i auditimit merr pjesërisht në konsideratë observacionet dhe ndryshimet janë reflektuar në raportin përfundimtar.*

*Pretendimi subjektiv: ... Në përfundim të kryerjes së shërbimit është mbajtur procesverbali mbi kryerjen e shërbimit të mirëmbajtjes së pajisjeve elektronike ku pjesë e këtij komisioni ishin dy antarë të njësisë së prokurimit dhe një anatar specialist fushe nga sektori i Teknologjisë së Informacionit. ...*

***Qëndrimi i grupit të auditimit:*** *Sqarojmë se, sipas pretendimit tuaj specialisti i fushës është përfshirë vetëm në fazën e kryerjes së shërbimit të mirëmbajtjes por theksojmë se sipas nenit 75, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, thuhet se të paktën një nga anëtarët e KVO duhet të jetë ekspert i fushës. Për sa më lart, grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim.*

*Pretendimi subjektiv: ...procesverbalet përkatëse të mbajtura dhe të firmosura nga të gjithë anëtarët e këtij Komisioni. ...Protokollimi i procesverbaleve nuk është kusht i domosdoshëm.*

...

***Qëndrimi i grupit të auditimit:*** *Sqarojmë se, nga shqyrtimi i dokumentacionit gjatë fazës së auditimit në terren, procesverbalet e përmendura në Projekt Raportin e Auditimit nuk kanë qenë të firmosura nga Komisioni. Çdo procesverbal i mbajtur në çdo fazë duhet të firmoset nga të gjithë anëtarët si dhe të protokollohet nga institucioni për vërtetësinë e dokumentacionit si dhe lënien e gjurmës së auditimit. Për sa më lart, grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim.*

*Pretendimi subjektiv: ...Në asnjë nga përcaktimet e nenit 40 të VKM-së nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, dhe as në manualin Teknik për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël nuk kërkohet raport përmbledhës.*



**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Sqarojmë se, në asnjë prej dosjeve nuk ndodhet raporti përmbledhës që parashikohet në nenin 99 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku thuhet se për çdo kontratë ose marrëveshje kuadër që mbulohet nga ligji autoriteti kontraktor duhet të hartojë një raport me shkrim ku duhet të përfshijë të dhënat e AK, emrat e kandidatëve të kualifikuar dhe atyre të skualifikuar etj. Për sa më lart, grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim.

**Pretendimi subjektiv:** ...Duke qenë se ky shërbim nuk ka shtrirje të gjatë në kohë për gjatë gjithë vitit atëherë nuk ka lindur nevoja për lidhje kontratë duke përdorur faturën e lëshuar nga ana e operatorit ekonomik fitues të barazvlefshme me kontratë...

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Sqarojmë se, lidhja e kontratës ndërmjet OE dhe AK është detyrim ligjor i parashikuar në dispozitat ligjore në fuqi. Përsa i përket pikës 10 të nenit 56, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, faturat kanë vlerën e kontratës së lidhur vetëm kur palët nuk kanë mundur të nënshkruajnë një të tillë. Argumentimi juaj se, nuk ka lindur nevoja për shkak të afatit kohor të kontratës nuk qëndron. Për sa më lart, grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim.

**1.Titulli i gjetjes:** ISHTI nuk ka përditësuar të dhënat e regjistrave realizimeve.

**Situata:** Grupi i auditimit shqyrtoi regjistrat e parashikimeve dhe të realizimeve të prokurimit publik nga i cili rezultoi se vlera e fondit limit në regjistrat e realizimeve në Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial nuk rakordojnë me vlerat reale të procedurave të prokurimit. Nga dokumentet shkresore si dhe nga komunikimi verbal me personat përgjegjës në institucion, rezultoi se kjo ka ardhur si pasojë e mos përditësimit të të dhënave ashtu siç parashikohet edhe në dispozitat ligjore në nenin 3 dhe 4 të VKM nr. 285 mbi regjistrin e parashikimeve dhe të realizimeve.

**Kriteri:** Neni 3 dhe 4 të VKM nr. 285 mbi regjistrin e parashikimeve dhe të realizimeve.

**Ndikimi/efekti:** Mos përditësimi i të dhënave bën që vlerat të mos rakordojnë me vlerat reale të procedurave të prokurimit.

**Shkaku:** Mos zbatimi i dispozitave ligjore dhe nënligjore.

**Rëndësia:** E lartë

**1.1.Rekomandimi:** Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial në të ardhmen të marrë masa për rakordimin e të dhënave në sistemin e APP për regjistrat e realizimit në mënyrë që vlerat në regjistrin e realizimeve të jenë vlerat reale të cilat janë përdorur për realizimin e një procedure prokurimi, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

**2.Titulli i gjetjes:** Problematika dhe mungesa mbi plotësimin e dokumentacioneve në përmbushje të përcaktimeve ligjore në dosjet prokurimit të audituara.

**Situata:** Nga auditimi i tre procedurave të prokurimit me vlerë të vogël me objekt:

-“Shërbim mirëmbajtje për pajisje elektronike”, për vitin 2020;

-“Bojra printeri, fotokopje, tonera”; për vitin 2021

-“Shërbim mirëmbajtje për pajisje elektronike”, për vitin 2021,

u konstatuan mangësi në:

-firmosjen dhe protokollimin e procesverbalit për përllogaritjen e fondit limit si dhe procesverbalin mbi kalimin tek operatori ekonomik i radhës;

-në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël të sipërpërmendura, asnjë nga anëtarët e komisionit nuk është ekspert i fushës, në kundërshtim me nenin 75/1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 parashikon se komisioni i vlerësimit të ofertave përbëhet nga jo më pak se tre persona, ku të paktën një prej anëtarëve është ekspert i fushës;

-për të treja procedurat e prokurimit nuk është hartuar raporti përmbledhës, në kundërshtim me përcaktimet ligjore në nenin 84 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

- për të dyja procedurat e prokurimit me objekt “Shërbim mirëmbajtje për pajisje elektronike”, Autoriteti Kontraktor (ISHTI) dhe Operatori Ekonomik nuk kanë nënshkruar kontratë ndërmjet palëve, në kundërshtim me përcaktimet e parashikuara në nenin 15/2 të ligji nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” si dhe në nenin 85 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**Kriteri:** Neni 15/2 dhe neni 99 i ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 85 dhe neni 75/1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”.

**Ndikimi/efekti:** Mungesa e dokumentacioneve sipas përcaktimeve ligjore sjell mos matjen e cilësisë së shërbimeve të përfituara nga investimet dhe ndërprerjen e gjurmës së auditimit.

**Shkaku:** Mos zbatimi i dispozitave ligjore.

**Rëndësia:** E lartë

**2.1.Rekomandimi:** Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial në cilësinë e Autoritetit Kontraktor dhe personat e autorizuar mbi hartimin dhe ndjekjen e procedurave të prokurimit, të marrin masa që për çdo procedurë prokurimi që do të zhvillojë në vijimësi të përmbushen përcaktimet e dispozitave ligjore dhe rregullative në fuqi.


### III.2.4. Auditimi i Sistemeve

Objektivi i auditimit të sistemeve dhe kontrolleve të aplikacioneve, për të dhënat Input / Output që ISHTI administron, është vlerësimi mbi efektivitetin e ndërtimit, operimit të kontrolleve të brendshme dhe saktësinë e funksionaliteteve që lidhen me procese të automatizuara si rezultat i zhvillimit informatik, që inspektorati ka pasur gjatë viteve.

Në përmbushje të drejtimit të auditimit “*Auditimi i sistemeve*”, u shqyrtuan dokumentacionet e mëposhtme:

- Përshkrim i përgjithshëm i sistemit të teknologjisë së informacionit në ISHTI;
- Të dhënat e gjeneruara nga sistemi për shërbimet e ofruara;
- U mor akses me përdorues me të drejta “lexues” në sistemin e-inspektimi;
- Aktet rregullative të inspektoratit që lidhen me sistemet dhe veprimet operacionale brenda dhe jashtë sistemit;
- Manualët e përdorimit të sistemit;
- Intervista të drejtpërdrejta me punonjësit;
- Të dhënat për përdoruesit e sistemit e-inspektimi;
- Analizë e performancës së sistemit;
- Etj.

Për periudhën nën auditim ISHTI është përdorues i sistemit “e-inspektimi”. Ky sistem administrohet nga AKSHI dhe Inspektorati Qendror.



Sistemi i inspektimeve “e-Inspektimi” i mundëson Inspektoratit Qendror dhe

Inspektorateve Shtetërore mjetet e nevojshme për të realizuar më lehtë proceset e tyre inspektuese dhe monitoruese konform ligjeve në fuqi.

Ky sistem mbulon të gjitha informacionet e nevojshme për të përgatitur dhe të kryer një procedurë inspektimi.

Veprimtaria e përditshme e inspektorateve shtetërore dhe e inspektorëve pasqyrohet në portalin unik të inspektimit “e-Inspektimi” dhe versionin mobile “e-Inspektimi”. Në mbështetje të këtij portali, Inspektorati Qendror ka të instaluar dhe konfiguruar një infrastrukturë qendrore hardware e cila është e hostuar në Data Centerin Qeveritar, pranë AKSHI-t.

*Komponentët kryesorë të këtij sistemi janë:*

**A.** Komponentët e sistemit online “e-Inspektimi”, në versionin Web janë:

- 1- Moduli i Portalit e-Inspection, i cili shërben si panel për administrimin e përmbajtjes që duhet të shfaqen në website-in [www.e-inspektimi.gov.al](http://www.e-inspektimi.gov.al).
- 2- Moduli i të dhënave të inspektorit, i cili shërben për menaxhimin e përdoruesve, inspektorateve që përdorin sistemin.
- 3- Moduli i Programimit, i cili shërben për konfigurimin e programeve vjetore, mujore dhe krijimin e gjenerimin e çështjeve brenda planit.
- 4- Moduli i Njohurive dhe të Mësuarit, i cili shërben për konfigurimin e listave verifikuese që përdoren gjatë inspektimeve.
- 5- Moduli i Administrimit të Çështjeve të Inspektimit, i cili shërben për krijimin e çështjeve jashtë planit dhe procedimin e çështjeve brenda apo jashtë planit sipas hapave përkatës që ndiqen gjatë një procesi inspektimi. Ky modul përfshin Sistemin e Administrimit të Inspektimeve (Case Administration Management System - CAMS), Sistemin e administrimit të Dokumenteve (Documents Management System - DMS) dhe Sistemin e Arkivimit të Dokumenteve (Records Management System - RMS)
- 6- Moduli i Riskut, i cili shërben për konfigurimet e faktorëve të riskut që ndikojnë në vlerësimin e riskut të subjektit, dhënien e vlerësimit nga inspektori për çdo faktor risku brenda çështjes nën inspektim dhe më pas përllogaritjen automatike finale të riskut të çdo subjekti që inspektohet, sipas formulave të specifikuar nga IQ (Inspektorati Qendror).
- 7- Moduli i Subjekteve dhe i të dhënave të Objekteve të Inspektimit, i cili shërben për ruajtjen e subjekteve që mund të inspektohen dhe aktivitetet përkatëse në të cilat operojnë subjektet.
- 8- Moduli i Raporteve, i cili shërben për shfaqjen e raporteve të ndryshme statistikore për Inspektoratin Qendror dhe Inspektoratet Shtetërore.
- 9- Moduli i ndërveprimit dhe komunikimit shërben për shkëmbimin e të dhënave me sistemet e institucioneve të tjera pjesë e rrjetit GovNet.

**B.** Komponentët e sistemit online “e-Inspektimi”, në versionin Mobile janë:

1. Modulin e mbledhjes së të dhënave të shërbimeve të të gjitha llojeve të Inspektorateve në nivel kombëtar, nëpërmjet rrjetit 4G/LTE.

2. Modulin e menaxhimit të të dhënave - të rendisë dhe ruajë informacionet (raportet) e gjeneruara gjatë punës së përditshme. Të dhënat duhet të jenë të organizuara në tabelë të detajuara, në mënyrë që informacioni i ruajtur lehtësisht në to, të jetë lehtësisht i lexueshëm dhe i përdorshëm për të krijuar raporte sipas nevojës së IQ.
3. Modulin e raportimeve on-line - duhet të gjenerojë raporte të optimizuara nga databaza qendrore.
4. Moduli i menaxhimit në Back Office - të mundësojë konfigurimet e ndryshme në çdo kohë në përputhje me ndryshimet që mund të ketë legjislacioni i përditësuar, menaxhimin e përdoruesve, të drejtave dhe kufizimeve, azhornimeve të nevojshme për aplikacionet nëpër терминаlet (tabletat) që janë në përdorim nga Inspektorët në gjithë vendin.
5. Moduli i suportit teknik (help desk) - të ofrojë shërbimin e suportit teknik dhe këshillimit procedural për Inspektorët, si dhe për të gjithë qytetarët apo subjektet e interesuara.
6. Modulin/ndërfaqen që bën të mundur për nënshkrimin elektronik të Aktit të Inspektimit. (nëpërmjet tabletit)
7. Moduli i sinkronizimit të të dhënave - të mundësojë sinkronizimin e të dhënave nga tableta në server dhe anasjelltas në mënyrë që aplikacioni të jetë i përdorshëm edhe kur nuk ka rrjet 4G/LTE, në modalitetin "offline".
8. Modulin/ndërfaqen për mundësimin e regjistrimit të të dhënave për pozicionimin gjeografik, si dhe regjistrimin e plotë elektronik të çështjes së inspektimit në Infrastrukturën e Serverave.

#### **A. Të drejtat e përdoruesve dhe menaxhimi i tyre**

Në sistemin e-inspektimi janë të regjistruar gjithsej 182 përdorues që janë pjesë e strukturës së ISHTI-t. Nga 182 përdorues në total, 159 përdorues janë hapur në rolin “inspektor”, ku nga ky rol 50 përdorues janë jo aktiv. Gjithashtu është hapur një përdorues në rolin “kryeinspektor shtetëror”; 1 përdorues në rolin “burime njerëzore”; 4 përdorues në rolin “drejtor inspektimi”; 3 përdorues në rolin “ligjor”, nga të cilët 1 përdorues është jo aktiv; si dhe ka 11 përdorues në rolin “përgjegjës sektori” nga të cilët një përdorues është jo aktiv.

*Nga auditimi mbi përdoruesit aktiv, të ndarë sipas roleve përkatëse në sistem u konstatua se:*

-Detyra e administratorit të sistemit në rolin e Administratorit të Inspektoratit Shtetëror nuk është e atribuar me anë të shkresës zyrtare nga organet drejtuese të ISHTI-t në mënyrë që të përcaktohen qartë të drejtat dhe detyrat e administratorit të sistemit, duke mos plotësuar kërkesat e përcaktuara në nenin 11, pika 9 të udhëzimit nr. 15 datë 07.05.2015 “Për miratimin e rregullave, Për përcaktimin e procedurave dhe mënyrave, për përdorimin e portalit unik të inspektimit “e-Inspektimi” të Inspektoratit Qendror.

#### **➤ Mënyra e çeljes së përdoruesve dhe politikat e vendosjes së fjalëkalimeve të përdoruesve dhe siguria e tyre**

Çelja e përdoruesve në sistemin e-inspektimi bëhen të bazuara në aktin e emërimit të punonjësit. Çelja e një useri të ri kalon disa faza vendimmarrëse të cilat kalojnë nga drejtoria e burimeve njerëzore në ISHTI, pastaj tek sektori i TIK në ISHTI, pastaj dërgohet (shkresa e emërimit të punonjësit) me anë të e-mailit zyrtar pranë njësisë TIK të AKSHIT atashuar pranë IQ. Pas konfirmimit procedohet me hapjen e userit të ri.

*Nga auditimi u konstatua se:*

-Fjalëkalimi i secilit përdorues në sistemin e-inspektimi në momentin e çeljes, sapo logohet përdoruesi (*first log-in*) me fjalëkalimin fillestar nuk të shfaqet automatikisht tabela e cila të kërkon vendosjen e fjalëkalimit të ri, ruajtjen e tij dhe rilogimin përsëri me anë të fjalëkalimit të ri.

-Sistemi nuk e ka të parametrizuar që pas një periudhe të standardizuar 30 ditore, automatikisht të të kërkojë rigjenerimin e fjalëkalimit.


Siguria e vendosjes së fjalëkalimit është e tipit kompleks ku kërkohen të ketë minimumi 8 karaktere, të ketë të paktën 1 shkronje dhe 1 shifër, asnjë përdoruesi nuk i rinovohet (resetohet) fjalëkalimi nëse nuk ka bërë kërkesë zyrtare (kërkesa dërgohet nga e-mail-i zyrtar i përdoruesit).

- Nuk janë dokumentuar politikat e sigurisë të implementuara për përdoruesit e sistemit, si dhe detyrimet që nevojiten të aplikohen në fjalëkalimet e tyre, bazuar në pikën 4 “Kërkesat e Sigurisë” pika a. të rregullores për “Administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike” të miratuar nga AKCESK<sup>1</sup> me urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019.

- Nuk janë dokumentuar politikat e sigurisë të implementuara për fjalëkalimet e sistemeve qendrore dhe administrimit bazuar në pikën 4 “Kërkesat e Sigurisë” pika b. Të rregullores për “Administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike” miratuara nga AKCESK me urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019.

- Mbështetur në manualin e përdorimit për burimet njerëzore të sistemit për shtimin e një përdoruesi të ri është e detyrueshme që të vendoset një foto, por nga verifikimi në sistem rezultuan që ka disa përdorues të ISHTI-t që nuk kanë foto.

Sipas informacionit të marrë nga specialisti i IT të AKSHI-t të atashura pranë IQ rezultoi se nuk mund të gjenerohen në format excel apo pdf, word, të dhënat mbi përdoruesit e ISHTI-t;



- nuk disponohet një akt rregullativ i dokumentuar dhe i miratuar për administrimin/menaxhimin e përdoruesve, në të cilën të jenë të përcaktuara procedurat që do të ndiqen për krijimin, fshirjen, ndryshimin e roleve dhe të të drejtave, ndryshimin e fjalëkalimeve të përdoruesve të ISHTI-it.

### **Manualet e sistemit e-Inspektimi:**

Manualet e sistemit e-inspektimi shërbejnë si udhëzues për të gjithë përdoruesit që kanë të drejta të aksesojnë sistemin e-inspektimi, dha ata përdorues që e përdorin dhe e popullojnë këtë sistem.

- *Manuali Përdorimi për rolin Kryeinspektor*

Ky dokument shërben si manual përdorimi për rolin Kryeinspektor lidhur me modulën e programimit (që ndodhet në portalin Sharepoint), modulën e çështjes dhe aplikacionin mobile.

- *Manuali Përdorimi për rolin Ligjor (Moduli i çështjeve)*

Ky dokument shërben si manual përdorimi për rolin Ligjor lidhur me modulën e çështjes.

- *Manuali Përdorimi për rolin Mbikëqyrje*

Ky dokument shërben si manual përdorimi për rolin Mbikëqyrje lidhur me modulën e të dhënave të inspektorëve, modulën e programimit, modulën e çështjes dhe raportet.

- *Manuali Përdorimi për versionin Mobile*

Ky dokument shërben si manual për të mësuar operacionet kryesore të menaxhimit të sistemit e-Inspektimi nëpërmjet aplikacionit mobile, navigimi i përdoruesit dhe funksionalitete të përgjithshme.

- *Manuali Përdorimi për rolin Ligjor (Konfigurimi i Riskut)*

Ky dokument shërben si manual përdorimi për rolin Ligjor lidhur me konfigurimin e riskut dhe ngarkimin e historikut të riskut të subjekteve.

<sup>1</sup> Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike

- *Manuali Përdorimi për rolin e Burimeve Njerëzore (Moduli i të dhënave të inspektorit)*  
Ky dokument shërben si manual përdorimi për rolin “Burimet Njerëzore” ku shpjegohen funksionalitetet e nevojshëm për këtë rol.

Nga auditimi u konstatua se:

- Manualët e përdorimit të sistemit nuk janë të miratuara nga asnjë prej organeve drejtuese të IQ apo ASKHI-t, si institucione që kanë në pronësi apo administrojnë sistemin e-inspektimi. Këto manuale janë në versionin e dorëzuar nga OE që ka implementuar sistemin.
- Manualët e sistemit të sipërcituara janë hartuar që në vitin 2017, vetëm në versionin fillestar që janë gjeneruar në momentin që është implementuar sistemi dhe nuk kanë pësuar asnjë ndryshim, përditësim, pavarësisht ndryshimeve të ndodhura në funksionalitetet e sistemit, ndryshimet strukturore të burimeve njerëzore, etj.
- Manualët e përdorimit të sistemit nuk janë të ndarë sipas funksionaliteteve të inspektorateve, por të njëjtët manuale përdoren për të gjithë inspektoratet, pavarësisht fushës së veprimit që mbulojnë. Rolet dhe përgjegjësitë nuk janë të reflektuar apo përditësuar në manualët e sistemit.

## **B. Verifikim i kontrolleve të aplikacioneve për të dhënat Input/Output**

### **I. Sistemi e-inspektimi**

Auditimi mbi sistemet e teknologjisë së informacionit u fokusua në sistemin e quajtur “*e-inspektimi*” i cili është sistemi kryesor për administrimin e procesit të inspektimeve në Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial.

Veprimtaria inspektuese e ISHTI-t si dhe mbikëqyrja e kësaj veprimtarie, kryhet online, nëpërmjet sistemit elektronik “*e-Inspektimi*”. “*e-Inspektimi*” është portali unik i inspektimit, që shërben për programimin dhe bashkërendimin e inspektimeve, për kryerjen e veprimtarisë së inspektimeve online, mbikëqyrjen e veprimtarisë inspektuese, shkëmbimin e të dhënave ndërmjet Inspektorateve Shtetërore / Vendore / Trupat e tjera inspektuese, sistemeve të tjera të dixhitalizuara të administratës shtetërore.

ISHTI nuk disponon sistem të vetin elektronik, për kryerjen e inspektimit online, por sistemi në të cilin regjistrohen, ndiqen dhe administrohen këto të dhëna për të gjithë inspektoratet në vend është sistemi “*e-inspektimi*”. Ky sistem është administruar deri në vitin 2017 nga Inspektorati Qendror (IQ), ndërsa që prej vitit 2018 administrohet nga AKSHI. Problematikat e këtij sistemi ISHTI i ka adresuar tek Inspektorati Qendror, si institucioni përgjegjës për përmirësimin e veprimtarive së inspektimit në Republikën e Shqipërisë. Aktualisht, ofruesi dhe mirëmbajtësi i këtij sistemi është Agjencia Kombëtare e Shërbimit të Informacionit (AKSHI). Hyrja dhe identifikimi i përdoruesve të sistemit e-inspektimi kryhet me emër përdoruesi dhe fjalëkalim.

Zgjidhja aktuale e sistemit “*e-Inspektimi*” është konceptuar të aksesohet në web që mund të aksesohet nga të gjithë përdoruesit nëpërmjet çdo pajisje që ka qasje në internet pa pasur nevojë për instalime të programeve specifik. Sistemi përdor ASP.NET Web Forms 4.7.2 dhe SharePoint 2016 si dhe disa komponentë të rinj përdorin ASP.NET MVC 5 dhe ASP.NET Web API 2 (që janë pjesë e ASP.NET) për të mbështetur aplikimin e ri për tableta i cili është ndërtaur në një teknologji me React Native.

Për ruajtjen e të dhënave të moduleve, sistemi e-Inspektimi përdor një cluster me SQL Server 2016 SP2 Enterprise Edition të konfiguruar me teknologjinë Always On Availability Groups e cila ofron performancë dhe siguri për ruajtjen e të dhënave.

Inspektorati Qendror ka përfunduar integrimin në sistemin elektronik për inspektimet online “*e-Inspektimi*” për të gjithë informacionin e kërkuar për Inspektoratet Shtetërore (strukturën e inspektoratit, të dhënat e përdoruesve sipas nivelit, dokumentet standarde të inspektimit, listat e verifikimit, legjislacionin, etj.). Në total janë pesëmbëdhjetë Inspektorate Shtetërore. Gjithashtu, pranë çdo Bashkie të Vendit (61 në total) funksionojnë Inspektoratet Vendore. Ka

përfunduar integrimi i 9 inspektorateve vendore: Tiranë, Sarandë, Gjirokastër, Finiq, Himarë, Vlorë, Durrës, Divjakë, Kavajë dhe pritjet të bëhet dhe integrimi i Inspektorateve të tjera Vendore.


Çdo inspektorat i përfshirë në sistemin e-Inspektimi ka mundësinë të kryejë inspektimet nëpërmjet aplikacionit mobile, me tabletë, ose nëpërmjet versionit Web.

➤ **Infrastruktura hardware dhe software e portalit “e-Inspektimi”**

Infrastruktura e sistemit elektronik, “e-Inspektimi”, përbëhet nga komponentët e mëposhtme fizike hardware:

- 6 (gjashtë) servera fizike;
- 1 (një) SAN storage të dedikuar;
- 1 (një) server fizik i veçantë për Testim DB dhe backup DC (Additional DC) për clusterin e Hyper-V 2012 R2, të cilat janë të instaluara në Data Centerin Qeveritar;
- 1 (një) Server për Active Directory dhe DNS i cili hostohet në mjediset e Inspektoratit Qendror;
- Encloser BLc7000 CTO3.

Mbi këtë infrastrukturë, janë ngritur të gjitha shërbimet bazë Active Directory, DNS Server dhe Hyper-V 2012 R2 në ambient të clusterizuar. Të gjithë komponentët e secilit element janë redundante për të lejuar vazhdimësinë e punës pa ndalesa deri në zgjidhjen e problemit.



Identifikimi dhe autorizimi i përdoruesve

Sistemi “e-Inspektimi” përdoret nga përdorues me kërkesa të ndryshme ndaj tij, pra duhet të kenë autoritete të ndryshme në sistem (shpesh hierarkike). Për këtë arsye sistemi “e-Inspektimi” grupon përdoruesit me funksionalitete dhe autoritete të njëjta në të njëjtin profil përdoruesish. Të gjitha funksionalitetet janë të përcaktuara në nivelin e profilit.

Sistemi “e-Inspektimi” është integruar tashmë në portalin e-Albania dhe në platformën govNet në të cilat identifikimi dhe autorizimi i përdoruesve bëhet nëpërmjet *Microsoft Active Directory* në ambientet e AKSHI-it.

Profilat e identifikuar në sistem janë:

- a. Inspektor i përgjithshëm
- b. Mbikëqyrje
- c. Metodologji
- d. Administrator i sistemit inspektorati qendror

- e. HR inspektorati
- f. Ligjor inspektorati
- g. Kryeinspektor shtetëror
- h. Kryeinspektor rajonal
- i. Inspektor
- j. Protokoll
- k. Administrator inspektorati
- l. Ministër

Profilat e sipërpërmendura administrohen në sistemin “e-Inspektimi” nëpërmjet panelit të administrimit të të drejtave të përdoruesve të SharePoint 2010.

Konfigurimi i grupeve të mësipërme kalon nëpër këto hapa:

- a. Në direktorinë active (AD) të serverit ku është hostuar aplikimi i “e-Inspektimi”, në ambientet e AKSHI-it krijohen grupet e sipërpërmendur.
- b. Përdoruesi me të drejta administrator në panelin administrativ të sistemit “e-Inspektimi” akseson panelin administrativ të sistemit.

➤ *Diagrama e rrjedhës së informacionit për sistemin e-inspektimi (workflow<sup>2</sup>)*

Diagramat shpjeguese se si informacioni rrjedh në sistemet e TI që mbështesin proceset e institucionet në vazhdimësi të plotësimit të gjurmës së auditimit, krijojnë pengesa në të paktën 3 drejtime, për:


- *Kuptimin*: Diagrami nxjerr në pah zona ku mungon kuptimi i sistemit dhe kontrolleve që janë implementuar në të.
- *Vlerësimin*: Nëpërmjet diagrameve, vetë punonjësit apo strukturat monitoruese mund të zbulojnë pikat e forta dhe dobësitë e kontrollit që është implementuar në sistem.
- *Gjurmimin*: Nëpërmjet diagrameve dokumentohet rruga që përshkon informacioni i regjistruar në sistem, deri në raportimin e të dhënave përfundimtare që janë institucionet tek të cilat inspektorati raporton.

*Diagrama e procesit të planifikimit*

---


<sup>2</sup> Termat që përdoren në gjuhën e TI për rrjedhën e informacionit janë: Workflow, Flowchart






**Burimi:** Inspektorati Qendror

*Diagrama e hapave të inspektimit*



**Burimi:** Inspektorati Qendror

## Diagrama e ndërtimit të procesverbalit të çështjes




**Burimi:** Inspektorati Qendror

*Dokumentet standarde inspektimi të ngarkuara në sistem, për kryerjen e inspektimit online:*

1. Autorizim Inspektimi;
2. Procesverbal Inspektimi;
3. Procesverbal Inspektimi aty për aty;
4. Procesverbal Inspektimi (I Posaçëm);
5. Vendim i Ndërmjetëm për Marrjen e Masës Urgjente;
6. Vendim Përfundimtar Inspektimi;
7. Vendim për Zgjidhjen e Ankimit të Veçantë;
8. Autorizim për Ndryshimin e Inspektorëve;
9. Kërkese për Refuzimin e të Autorizimit të Inspektorit;
10. Kërkese për Shtyrje të Autorizimit të Inspektimit;
11. Vendim për Shtyrje të Autorizimit të Inspektimit;
12. Vendim i Komisionit të ankimit;
13. Ankese për Vendimin Përfundimtar;
14. Ankimi i Veçantë.

### ➤ *Mbi funksionalitet e sistemit e-inspektimi*

Sistemi e-inspektimi është një sistem modular i ndërtuar në module të ndryshme. Modulet që përfshihen në sistemin e-inspektimi janë konkretisht si në diagramën e mëposhtme:




**Burimi:** Inspektorati Qendror. Punoi Grupi i Auditimit

Sistemi e-inspektimi është sistemi kryesor në të cilin ISHTI e mbështet aktivitetin e tij institucional mbi programimin dhe bashkërendimin e inspektimeve, për kryerjen e veprimtarisë së inspektimeve online, mbikëqyrjen e veprimtarisë inspektuese. Mosfunksionimi i këtij sistemi do të kishte ndjeshmëri dhe ndikim të lartë në ushtrimin e aktivitetit të inspektorateve në ushtrimin e kompetencave të tyre.

*Nga auditimi mbi funksionalitet e sistemit e-inspektimi u konstatua se:*

-Portali e-inspektimi nuk mund të aksesohet në të gjithë webbrowser-at. Gjatë testimit në terren u testua të log in, me anë të browserit “Microsoft Edge” por nuk mund të aksesohet dhe shfaqet mesazhi i mëposhtëm:



*Në modulën e “çështjeve të inspektimit” u konstatua se:*

-Në disa raste gjatë zhvillimit të procesit inspektues, përdoruesve u shfaqen problematika mbi gjenerimin e vendndodhjes në tablet;

-Në momentin kur inspektori në çështjen përkatëse e krijon si ri-inspektim ato në sistem dalin të krijuara dy herë;

-Në disa raste është vërejtur se inspektorët, pasi gjenerojnë dokumentet si, Proces Verbalin, Listë Verifikimin dhe Vendimin Përfundimtar, statusi i këtyre çështjeve nuk del “Mbyllur” por vazhdon të jetë në progres;

-Përgjatë vitit 2022 janë hasur raste në versionin web dhe mobile ku sistemi nuk hapet dhe shfaqet error: “Service is unaviable” dhe “HTTP error 503”;

-Në disa raste në versionin web të sistemit e-inspektimi është hasur një error i cili shfaqet: “Lidhje me serverin dështoi”;

- Gjatë procesit të inspektimit është hasur një problematikë nga inspektorët të cilët pasi mbyllin procesin e inspektimit në sistem dhe më pas u duhet të dërgojnë në format elektronik “e-mail” të dhënat përkatëse, u konstatua se ky e-mail nuk shkon në destinacionin e përcaktuar;

-Kur krijohen çështjet në modulën e çështjeve dhe programimit, emri i një subjekti që përsëritet më shumë se 15 herë, nuk mund të regjistrohet në sistem. Për këtë arsye për të futur të gjithë subjektet e programuara në planin vjetor, ato regjistrohen në sistem në modulën e-inspektime/skeduli i çështjeve, me statusin “të programuara”. Praktikisht plani vjetor është në

letër por nuk mund të hidhet i gjithi në sistem për shkak të kësaj problematike mbi përsëritjen e të njëjtit nipt. Kjo gjë krijon probleme pasi ka kompani të cilat kanë më shumë se një degë në të gjithë vendin por kanë një nipt të vetëm. Pra praktikisht këto subjekte nuk mund të inspektohen më shumë se 15 herë për shkak të pengesës së trajtuar më lart në sistem, edhe pse kanë më shumë degë në të gjithë vendin.


-Tek moduli i çështjeve të inspektimit nuk shfaqen të gjitha ri inspektimet dhe kur kërkohet me arsyen ri inspektim.

Në modulin “krijo çështje” u konstatua se:

-Në fazën e një procesi inspektimi jashtë planit vjetor dhe mujor, mungon mundësia e zgjedhjes së një arsyeje tjetër përveç atyre të paracaktuara në sistem. Mundësia e shtimit të arsyeve ose argumenteve sipas argumenteve specifike që inspektori e gjykon sipas situatës që konstaton, do të lehtësonte procesin e inspektimit në fazë.



-Në modulin e çështjeve të inspektimit tek fusha “inspektori”, përdoruesi nuk ka një opsion zgjedhjeje për të shkruar ose për të kërkuar (search) emrin e plotë të inspektorit që do të shtojë ose përzgjedhë.




-Përditësimi i degëve të subjektit nuk realizohet automatikisht tek fusha bizneset pa bërë search manual tek fusha bizneset.

Në modulin e “programimit” u konstatua se:

-Inspektorët e larguar duhet të jenë jo aktiv të paselektueshëm kur krijojnë çështje “Tek përcaktimi i programeve mujore”;

Në modulin e “skeduli i çështjeve” u konstatua se:

Anulimi i çështjeve:



Në momentin kur një çështje anulohet për një arsye të caktuar, në modulin e çështjeve, në momentin që kërkohet arsyeja e anulimit të çështjeve, përdoruesit (në këtë rast Kryeinspektorit) i shfaqet vetëm një mundësi zgjedhjeje: “hedhur gabimisht”. Dhe më pas në dritaren e mëposhtme përdoruesi vendos arsyen se pse është anuluar çështja, duke cituar numrin e protokollit të shkresës dhe datën. Pra sistemi nuk të ofron mundësi që të zgjedhës një arsye tjetër përveç asaj të paracaktuarës dhe nuk ke mundësi të upload-osh dokumentin justifikues që citohet në përshkrimin e anulimit. Kjo gjë ndikon negativisht, në ndërprerjen e gjurmës së auditimit, pasi për të parë të gjithë procesin në sistem se pse është anuluar një çështje, do të duhet ta lexosh numrin e shkresës së hedhur manualisht në sistem dhe pastaj të shkosh në zyrën e protokoll arkivës për të marrë dokumentin justifikues me argumentet përkatëse.

#### Mbi shtyrjen e një procesi inspektues:

Zhvillimi i një procesi inspektues realizohet njëkohësisht në formë shkresore dhe elektronike në sistemin e-inspektime, si dhe kalohet nëpër disa faza, konkretisht:

Fillimisht popullohet dhe ngarkohet në sistem autorizimi nga Kryeinspektori i cili përcakton kohëzgjatjen e inspektimit, datën dhe orën e fillimit dhe të dhëna të tjera të nevojshme për procesin inspektues. Pas konfirmimit të autorizimit në sistem, inspektorët e përcaktuar në autorizimin përkatës, fillojnë procesin inspektues ku ndiqen hallkat e kontrollit të cilat fillojnë me Listë Verifikime, Procesverbali, Vendimi Përfundimtar, Dokumentet bashkëlidhur si dhe foto apo video të subjektit të inspektuar. Pas plotësimit dhe firmosjes së këtyre dokumenteve në sistem, për secilin dokument, kërkohet vendndodhja me GPS, nga tableti, që tregon dhe përcakton vendndodhjen nëse dokumenti është populluar në subjektin e përcaktuar në autorizimin për inspektim. Të gjitha këto hallka plotësohen njëra pas tjetrës në mënyrë kronologjike.

Çfarë ndodh në rastet kur një proces inspektimi i cili ka marrë autorizimin për të filluar, shtyhet për një arsye të caktuar?

Në rastet kur një proces inspektimi shtyhet për një arsye të caktuar dhe procesi i inspektimit nuk realizohet në periudhën e përcaktuar në autorizimin e parë të Kryeinspektorit, atëherë procesi duhet të rivijojë me një autorizim të ri që shtyhet në periudhën për javën pasardhëse. Nga auditimi u konstatua se sistemi e-inspektime nuk ka element kontrolli mbi këtë fazë dhe i lejon inspektorët që të procedojnë në sistem me procesin e inspektimit me plotësimin e hapave të mëtejshëm edhe pse nuk është hedhur akoma autorizimi i ri në sistem që duhet aprovuar nga

Kryeinspektori. Në këto raste autorizimi i ri miratohet pasi ka mbaruar i gjithë procesi i inspektimit dhe është dhënë dhe vendimi përfundimtar.

Pra sistemi nuk ia ndërpret procesin inspektorit që të vazhdojë në hallkat e tjera por ja lejon atij të vazhdojë të kryejë procesin inspektues pa u miratuar akoma autorizimi i ri nga Kryeinspektori.

Inspektori	Data e Caktimit	Eshhtë Kryesor?	
Julian Cizmja	06/02/2023	<input type="checkbox"/>	<input type="button" value="Shëruar"/>
Taulant Saqo	06/02/2023	<input type="checkbox"/>	<input type="button" value="Rokujto"/>

2 inspektore të caktuar për çështjen.

Shto Inspektor  
 Inspektori: --Zgjidh--  
 Kryesor:  Po  Jo

**Autorizimi** | Listë Verifikimi | Procesverbal | Dokumenta | Foto/Video | Gjobat | Harta

Kohëzgjatja e inspektimit: Pese dite

\* Data/Ora: 06/02/2023 09:00 (filimi) | 10/02/2023 14:00 (mbarimi)

\* Tipi i Autorizimit: Me njoftim

A ka persona të tjerë të autorizuar?  (Nëse përgjigja është PO, zgjidhni kutinë)

\* Objekti i inspektimit: Inspektimi i pajisjeve dhe instalimeve elektrike.

\* Listat e Verifikimit të Inspektoritit:
 

- LISTE VERIFIKIMI PËR GARANTIMIN E SIGURISË SE PUNËS SE PAISJEVE DHE INSTALIMEVE ELEKTRIKE
- LISTE VERIFIKIMI PËR OPERATORET PRODHUES, IMPORTUES, MONTUES DHE SHFRYTEZUES TE PAISJEVE INSTALIMEVE NEN PRESION
- LISTE VERIFIKIMI PËR SIGURINË E PRODUKTEVE MEKANIKE ELEKTRIKE
- LISTE VERIFIKIMI PËR STACIONET E TRËGITIMIT ME PAKICË TE KARBURANTEVE

Listat e Verifikimit të zgjedhura për çështjen

ID	Lista e Verifikimit	Info		
243	Mbi kërkesat e ligjit nr 8734 date 01.02.2001		<input type="button" value="Shiko"/>	<input type="button" value="Fshij"/>


1 listat verikimi e zgjedhur.

Vendi ku do të kryhet inspektimi


### Versioni mobile i sistemit e-inspektimi:

Për të aksesuar sistemin e-inspektimi nga inspektorët në terren, grupet e inspektimit janë të pajisur me tablet në funksion të ushtrimit të detyrave funksionale.

### Tablet Lenovo TAB 8







Në tabletet që përdorin inspektorët për inspektim fillimisht instalohet një version mobile i sistemit e-inspektimi. Për instalimin e aplikacionit, specialisti i IT-së shkarkon një file “apk” nga një link i dedikuar që shërben për shkarkimin e paketës dhe versionit të software-it që nevojitet për tu instaluar në tablet.

Pas shkarkimit të file-it, specialisti e hap file dhe fillon instalimin e versionit mobile në tablet. Pas instalimit, aplikacioni ka një logo të tillë fillestare :



Inspektori për tu loguar në këtë app duhet të përdorët të njëjtat kredenciale që përdor për tu loguar në versionin web.

*Nga auditimi u konstatua se:*

-Versioni mobile i sistemit e-inspektimi vazhdimisht punon me ndërprerje dhe ka probleme me ecurinë normale të punës duke ndikuar negativisht në veprimtarinë e punës së inspektorëve. Ky version ka nevojë për përditësime dhe upgrade;

-Në faqen e parë të versionit mobile pasi inspektori logohet, i shfaqen të gjitha çështjet e hapura për të gjithë muajin, pra në qoftë se inspektorit do ti nevojitet të shohë një çështje të tijën, i duhet të bëjë search për ta gjetur;

-Gjatë krijimit të një çështje në sistem, inspektori i cili po krijon çështjen për të shtuar inspektorin e dytë në çështje, i duhet të bëjë scroll të gjithë listën e emrave të inspektorëve pasi sistemi nuk ta ofron mundësinë të bësh search në këtë

fushë;

-Tek fusha “Aktiviteti ILO” që zgjedh inspektori, gjatë krijimi të një çështjeje, nuk i shfaqet mundësia për të zgjedhur një lloj tjetër subjekti që ka p.sh bombula ose pajisja nën presion përveç formës GLN (Gaz i lëngshëm). Pra sistemi të ofron të zgjedhës vetëm këtë mundësi GLN pavarësisht se subjekti që do të inspektohet nuk ka këtë lloj bombule, inspektori është i detyruar ta zgjedhë këtë mundësi pasi nuk ka opion tjetër;

-Sistemi nuk e ndalon të procedohet një çështje të cilës i është përcaktuar afati i fillimit dhe mbarimit. Pra në qoftë se një çështje ka të përcaktuar në autorizimin përkatës afatin e fillimit dhe mbarimit të saj, një inspektor mund të punojë në këtë çështje edhe pasi të ketë kaluar afati i përfundimit të përcaktuar në autorizim. Pra çështja nuk mbyllet kur është e përcaktuar në sistem në autorizim por në të mund të punohet deri kur ta mbyllë inspektori;

-Tek Lista e verifikimit të subjekteve që plotësohet nga inspektorët në terren, në rast se inspektorët verifikojnë që një subjekt ka një pajisje nën presion për të cilën nuk disponon dokumentacionin e nevojshëm atëherë inspektorit nuk i shfaqet një mundësi që të zgjedhë

shënimin, që subjekti i inspektuar ti lihet afat për të plotësuar dokumentacionin e nevojshëm për pajisjen nën presion, pa qenë nevoja për plotësimin e të gjithë listës së verifikimit;

-Përgjatë vitit 2022 janë hasur raste në versionin mobile në tabletë ku pasi inspektorët logohen nuk ju dalin çështjet e tyre në progres edhe kur në sistem janë të hapura;

-Ka raste që sistemi nuk merr vendndodhjen e saktë në zona të caktuara kur nuk ka sinjal të mirë. Në këto raste inspektorëve ju duhet ta ruajnë çështjen në mënyrë që ta sinkronizojnë në një moment të dytë kur të kenë sinjal interneti;

-Inspektorët duhet të përdorin internetin e tyre ose të subjektit që po inspektojnë për të ngarkuar dhe sinkronizuar çështjen me të cilën po punojnë, pasi pajisjet tablet nuk kanë internet për ta kryer këtë proces.

*Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është mbajtur Aktkonstatimi nr. 4, datë 15.03.2023, protokolluar në ISHTI me shkresën nr. 07/5, datë 15.03.2023, si dhe është trajtuar në faqet 29-47 të Projektraportit të Auditimit mbi të cilin nuk janë paraqitur observacione.*

**1.Titulli i gjetjes:** Problematika mbi administrimin dhe identifikimin e përdoruesve.

**Situata:** Nga auditimi u konstatua se:

- Detyra e administratorit të sistemit në rolin e Administratorit të Inspektoratit Shtetëror nuk është e atribuar me anë të shkresës zyrtare nga organet drejtuese të ISHTI-t në mënyrë që të përcaktohen qartë të drejtat dhe detyrat e administratorit të sistemit, duke mos plotësuar kërkesat e përcaktuara në nenin 11, pika 9 të udhëzimit nr. 15 datë 07.05.2015 “Për miratimin e rregullave, Për përcaktimin e procedurave dhe mënyrave, për përdorimin e portalit unik të inspektimit “e-Inspektimi” të Inspektoratit Qendror.

- Nuk disponohet një akt rregullativ i dokumentuar dhe i miratuar për administrimin/menaxhimin e përdoruesve, në të cilën të jenë të përcaktuara procedurat që do të ndiqen për krijimin, fshirjen, ndryshimin e roleve dhe të të drejtave, ndryshimin e fjalëkalimeve të përdoruesve të ISHTI-it.

**Kriteri:** Neni 11, pika 9 të udhëzimit nr. 15 datë 07.05.2015 “Për miratimin e rregullave, Për përcaktimin e procedurave dhe mënyrave, për përdorimin e portalit unik të inspektimit “e-Inspektimi”. Neni 27, Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar; Ligji nr. 2/2017 “Për sigurinë kibernetike”.

**Ndikim/Efekti:** Mos dokumentim i të drejtave dhe detyrimeve që kanë të gjithë përdoruesit e sistemit.

**Shkaku:** Mos administrimi i menaxhimit të ndryshimit.

**Rëndësia:** E mesme

**1.1.Rekomandimi:** Organet drejtuese të Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial të marrin masa për përcaktimin e administrator-it të sistemit dhe përgjegjësive dhe të drejtave të tij në rolin e Administratorit të Inspektoratit Shtetëror sipas përcaktimeve rregullatore. Gjithashtu të marrin masa për të hartuar dhe miratuar një akt rregullativ për administrimin/menaxhimin e përdoruesve aktiv dhe jo aktiv të ISHTI, në të cilën të jenë të përcaktuara procedurat që ndiqen për krijimin, fshirjen, ndryshimin e roleve dhe të të drejtave, ndryshimin e fjalëkalimeve të përdoruesve të Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial. Të merren në konsideratë praktikatat e përcaktuara në rregulloren për “Administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike” miratuar nga AKCESK.

**2.Titulli i gjetjes:** Parregullsi që i adresohen politikave të sigurisë së identifikimit të përdoruesve.

**Situata:** Nga auditimi u konstatua se:

- Fjalëkalimi i secilit përdorues në sistemin e-inspektimi në momentin e çeljes, sapo logohet përdoruesi (first log-in) me fjalëkalimin fillestar nuk të shfaqet automatikisht tabela e cila të



kërkon vendosjen e fjalëkalimit të ri, ruajtjen e tij dhe rilogimin përsëri me anë të fjalëkalimit të ri.

- Sistemi nuk e ka të parametrizuar që pas një periudhe të standardizuar 30 ditore, automatikisht të të kërkojë rigjenerimin e fjalëkalimit.

- Nuk janë dokumentuar politikat e sigurisë të implementuara për përdoruesit e sistemit, si dhe detyrimet që nevojiten të aplikohen në fjalëkalimet e tyre, bazuar në pikën 4 “Kërkesat e Sigurisë” pika a. të rregullores për “Administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike” të miratuar nga AKCESK me urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019.

- Nuk janë dokumentuar politikat e sigurisë të implementuara për fjalëkalimet e sistemeve qendrore dhe administrimit bazuar në pikën 4 “Kërkesat e Sigurisë” pika b. Të rregullores për “Administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike” miratuara nga AKCESK me urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019.

- Mbështetur në manualin e përdorimit për burimet njerëzore të sistemit për shtimin e një përdoruesi të ri është e detyrueshme që të vendoset një foto, por nga verifikimi në sistem rezultuan që ka disa përdorues të ISHTI-t që nuk kanë foto.

**Kriteri:** Pika 4 “Kërkesat e Sigurisë” pika a, e rregullores për “Administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike” miratuar nga AKCESK me urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019; Forcimin i fjalëkalimit si element sigurie është në standardin “Two Factor Authentication”. Neni 11, pika 9 të udhëzimit nr. 15 datë 07.05.2015 “Për miratimin e rregullave, Për përcaktimin e procedurave dhe mënyrave, për përdorimin e portalit unik të inspektimit “e-Inspektimi”. Neni 27, Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar; Ligji nr. 2/2017 “Për sigurinë kibernetike”; VKM Nr. 710, datë 21.08.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, i ndryshuar.

**Ndikim/Efekti:** Mos përcaktim dhe mosnjohje e të drejtave dhe detyrimeve që kanë të gjithë përdoruesit e sistemit.

**Shkaku:** Mungesa e rregullave të dokumentuara dhe implementimi i tyre mbi sigurinë e fjalëkalimeve të përdoruesve.

**Rëndësia:** E lartë

**2.1.Rekomandimi:** Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial në bashkëpunim me Inspektoratin Qendror (IQ) të marrin masa për të dokumentuar politikat e sigurisë të implementuara për përdoruesit e sistemit, si dhe detyrimet që nevojiten të aplikohen në fjalëkalimet e tyre sipas përcaktimeve rregullatore të AKCESK. Gjithashtu të merren masa për adresimin e çështjeve të konstatuar nga grupi i auditimit, me qëllim rritjen e sigurisë së identifikimit të përdoruesve.

**3.Titulli i gjetjes:** Manualet e sistemit e-inspektimi

**Situata:** Nga auditimi mbi manualet e përdorimit të aplikacionit “e-inspektimi” u konstatua se:

- Manualet e përdorimit të sistemit nuk janë të miratuara nga asnjë prej organeve drejtuese të IQ apo ASKHI-t, si institucione që kanë në pronësi apo administrojnë sistemin e-inspektimi. Këto manuale janë në versionin e dorëzuar nga OE që ka implementuar sistemin.
- Manualet e sistemit janë hartuar që në vitin 2017, vetëm në versionin fillestar që janë gjeneruar në momentin që është implementuar sistemi dhe nuk kanë pësuar asnjë ndryshim, përditësim, pavarësisht ndryshimeve të ndodhura në funksionalitet e sistemit, ndryshimet strukturore të burimeve njerëzore, etj.
- Manualet e përdorimit të sistemit nuk janë të ndarë sipas funksionaliteteve të inspektorateve, por të njëjtët manuale përdoren për të gjithë inspektoratet, pavarësisht fushës së veprimit që mbulojnë. Rolet dhe përgjegjësitë nuk janë të reflektuar apo përditësuar në manualet e sistemit.

**Kriteri:** Efektiviteti në përdorim të sistemit e-inspektimi dhe neni 20 i ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

**Ndikim/Efekti:** Mos adresim i përgjegjësive si pasojë e keq adresimit të përcaktimit të detyrave, kompetencave dhe përgjegjësive.

**Shkaku:** Mos përditësim i akteve rregullative.

**Rëndësia:** E mesme

**3.1.Rekomandimi:** Inspektorati Qendror si institucioni që bashkërendon dhe mbështet veprimtarinë e inspektorateve shtetërore të përditësojë dhe miratojë, manualët e përdorimit të sistemit e-inspektimi duke reflektuar ndryshimet institucionale, strukturore dhe kompjuterike të ndodhura në inspektoratet shtetërore.

**4.Titulli i Gjetjes:** Problematika të identifikuar nga testimi në modulet e sistemit e-inspektimi  
**Situata 1:** Nga auditimi mbi funksionalitet e sistemit e-inspektimi u konstatua se:

➤ Në modulën e “çështjeve të inspektimit” u konstatua se:

-Në disa raste gjatë zhvillimi të procesit inspektues, përdoruesve u shfaqën problematika mbi gjenerimin e vendndodhjes në tablet;

-Në momentin kur inspektori në çështjen përkatëse e krijon si ri-inspektim ato në sistem dalin të krijuara dy herë;

-Në disa raste është vërejtur se inspektorët, pasi gjenerojnë dokumentet si, Proces Verbalin, Listë Verifikimin dhe Vendimin Përfundimtar, statusi i këtyre çështjeve nuk del “Mbyllur” por vazhdon të jetë në progres;

-Përgjatë vitit 2022 janë hasur raste në versionin web dhe mobile ku sistemi nuk hapej dhe shfaqte error: “*Service is unaviable*” dhe “*HTTP error 503*”;

-Në disa raste në versionin web të sistemit e-inspektimi është hasur një error i cili shfaqej: “*Lidhje me serverin dështoi*”;

- Gjatë procesit të inspektimit është hasur një problematikë nga inspektorët të cilët pasi mbyllin procesin e inspektimit në sistem dhe më pas u duhet të dërgojnë në format elektronik “e-mail” të dhënat përkatëse, u konstatua se ky e-mail nuk shkon në destinacionin e përcaktuar;

-Kur krijohen çështjet në modulën e çështjeve dhe programimit, emri i një subjekti që përsëritet më shumë se 15 herë, nuk mund të regjistrohet në sistem. Për këtë arsye për të futur të gjithë subjektet e programuara në planin vjetor, ato regjistrohen në sistem në modulën e-inspektive/skeduli i çështjeve, me statusin “*të programuara*”. Praktikisht plani vjetor është në letër por nuk mund të hidhet i gjithi në sistem për shkak të kësaj problematike mbi përsëritjen e të njëjtit nipt. Kjo gjë krijon probleme pasi ka kompani të cilat kanë më shumë se një degë në të gjithë vendin por kanë një nipt të vetëm. Pra praktikisht këto subjekte nuk mund të inspektohen më shumë se 15 herë për shkak të pengesës së trajtuar më lart në sistem, edhe pse kanë më shumë degë në të gjithë vendin;

-Tek moduli i çështjeve të inspektimit nuk shfaqen të gjitha ri inspektimet dhe kur kërkohet me arsyen ri inspektim.

➤ Në modulën “krijo çështje” u konstatua se:

-Në fazën e një procesi inspektimi jashtë planit vjetor dhe mujor, mungon mundësia e zgjedhjes së një arsyeje tjetër përveç atyre të paracaktuara në sistem. Mundësia e shtimit të arsyeve ose argumenteve sipas argumenteve specifike që inspektori e gjykon sipas situatës që konstaton, do të lehtësonte procesin e inspektimit në fazë;

-Në modulën e çështjeve të inspektimit tek fusha “inspektori”, përdoruesi nuk ka një opsion zgjedhjeje për të shkruar ose për të kërkuar (search) emrin e plotë të inspektorit që do të shtojë ose përzgjedhë;

-Përditësimi i degëve të subjektit nuk realizohet automatikisht tek fusha bizneset pa bërë search manual tek fusha bizneset.

➤ Në modulën e “programimit” u konstatua se:

-Inspektorët e larguar duhet të jenë jo aktiv të paselektueshëm kur krijojnë çështje “*Tek përcaktimi i programeve mujore*”;

➤ Në modulën e “skeduli i çështjeve” u konstatua se:

Sistemi nuk të ofron mundësi që të zgjedhësh një arsye tjetër përveç asaj të paracaktuarës dhe nuk ke mundësi të upload-osh dokumentin justifikues që citohet në përshkrimin e anulimit. Kjo gjë ndikon negativisht, në ndërprerjen e gjurmës së auditimit, pasi për të parë të gjithë procesin në sistem se pse është anuluar një çështje, do të duhet ta lexosh numrin e shkresës së hedhur manualisht në sistem dhe pastaj të shkosh në zyrën e protokoll arkivës për të marrë dokumentin justifikues me argumentet përkatëse.

➤ Mbi shtyrjen e një procesi inspektues

Në rastet kur një proces inspektimi shtyhet për një arsye të caktuar dhe procesi i inspektimit nuk realizohet në periudhën e përcaktuar në autorizimin e parë të Kryeinspektorit, atëherë procesi duhet të rivijojë me një autorizim të ri që shtyhet në periudhën për javën pasardhëse. Nga auditimi u konstatua se sistemi e-inspektime nuk ka element kontrolli mbi këtë fazë dhe i lejon inspektorët që të procedojnë në sistem me procesin e inspektimit me plotësimin e hapave të mëtejshëm edhe pse nuk është hedhur akoma autorizimi i ri në sistem që duhet aprovuar nga Kryeinspektori. Në këto raste autorizimi i ri miratohet pasi ka mbaruar i gjithë procesi i inspektimit dhe është dhënë dhe vendimi përfundimtar.

Pra sistemi nuk ia ndërpret procesin inspektorit që të vazhdojë në hallkat e tjera por ja lejon atij të vazhdojë të kryejë procesin inspektues pa u miratuar akoma autorizimi i ri nga Kryeinspektori.

**Kriteri:** Veprimtaria inspektuese e realizuar nëpërmjet sistemit e-inspektimi

**Ndikim/Efekti:** Të dhëna të paplota, plotësime fiktive, vështirësi të realizimit të detyrave inspektuese.

**Shkaku:** Mos dhënia rëndësi e problematikave që hasin përdoruesit në sistem

**Rëndësia:** E lartë

**4.1.Rekomandimi:** Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial në bashkëpunim me Inspektoratin Qendror të analizojë dhe adresojë tek ofruesi i shërbimit të mirëmbajtjes parregullsitë, mangësitë e konstatuara nga auditimi dhe të ofrojnë zgjidhje për to me qëllim përmirësimin e performancës së funksionimit të sistemit e-inspektimi, si dhe të merren masa për shtimin e funksionaliteteve të reja në sistemin e-inspektimi sipas nevojës së përdoruesve në sistem.

**5.Titulli i Gjetjes:** Problematikat në versionin mobile të sistemit e-inspektimi.

**Situata:** Nga auditimi u konstatua se:

-Versioni mobile i sistemit e-inspektimi vazhdimisht punon me ndërprerje dhe ka probleme me ecurinë normale të punës duke ndikuar negativisht në veprimtarinë e punës së inspektorëve. Ky version ka nevojë për përditësime dhe upgrade;

-Në faqen e parë të versionit mobile pasi inspektori logohet, i shfaqen të gjitha çështjet e hapura për të gjithë muajin, pra në qoftë se inspektorit do ti nevojitet të shohë një çështje të tijën, i duhet të bëjë search për ta gjetur;

-Gjatë krijimit të një çështje në sistem, inspektori i cili po krijon çështjen për të shtuar inspektorin e dytë në çështje, i duhet të bëjë scroll të gjithë listën e emrave të inspektorëve pasi sistemi nuk ta ofron mundësinë të bësh search në këtë fushë;

-Tek fusha “Aktiviteti ILO” që zgjedh inspektori, gjatë krijimi të një çështjeje, nuk i shfaqet mundësia për të zgjedhur një lloj tjetër subjekti që ka p.sh bombula ose pajisja nën presion përveç formës GLN (Gaz i lëngshëm). Pra sistemi të ofron të zgjedhësh vetëm këtë mundësi GLN pavarësisht se subjekti që do të inspektohet nuk ka këtë lloj bombule, inspektori është i detyruar ta zgjedhë këtë mundësi pasi nuk ka opsion tjetër;

-Sistemi nuk e ndalon të procedohet një çështje të cilës i është përcaktuar afati i fillimit dhe mbarimit. Pra në qoftë se një çështje ka të përcaktuar në autorizimin përkatës afatin e fillimit dhe mbarimit të saj, një inspektor mund të punojë në këtë çështje edhe pasi të ketë kaluar afati i përfundimit të përcaktuar në autorizim. Pra çështja nuk mbyllet kur është e përcaktuar në sistem në autorizim por në të mund të punohet deri kur ta mbyllë inspektori;

-Tek Lista e verifikimit të subjekteve që plotësohet nga inspektorët në terren, në rast se inspektorët verifikojnë që një subjekt ka një pajisje nën presion për të cilën nuk disponon dokumentacionin e nevojshëm atëherë inspektorit nuk i shfaqet një mundësi që të zgjedhë shënimin, që subjekti i inspektuar ti lihet afat për të plotësuar dokumentacionin e nevojshëm për pajisjen nën presion, pa qenë nevoja për plotësimin e të gjithë listës së verifikimit;

-Përgjatë vitit 2022 janë hasur raste në versionin mobile në tabletë ku pasi inspektorët logohen nuk ju dalin çështjet e tyre në progres edhe kur në sistem janë të hapura;

-Ka raste që sistemi nuk merr vendndodhjen e saktë në zona të caktuara kur nuk ka sinjal të mirë. Në këto raste inspektorëve ju duhet ta ruajnë çështjen në mënyrë që ta sinkronizojnë në një moment të dytë kur të kenë sinjal interneti;

-Inspektorët duhet të përdorin internetin e tyre ose të subjektit që po inspektojnë për të ngarkuar dhe sinkronizuar çështjen me të cilën po punojnë, pasi pajisjet tablet nuk kanë internet për ta kryer këtë proces.

**Kriteri:** Veprimtaria inspektuese e realizuar nëpërmjet sistemit e-inspektimi.

**Ndikim/Efekti:** Të dhëna të paplota, plotësime fiktive, vështirësi të realizimit të detyrave inspektuese.

**Shkaku:** Mungesa e internetit në pajisjet tablet, si dhe mos dhënia rëndësi e problematikave që hasin përdoruesit në sistem.

**Rëndësia:** E lartë

**5.1.Rekomandimi:** Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial në bashkëpunim me Inspektoratin Qendror të analizojë dhe adresojë tek ofruesi i shërbimit të mirëmbajtjes parregullsitë, mangësitë e konstatuara nga auditimi në aplikacionin mobile të sistemit e-inspektimi. Të përditësojnë aplikacionin mobile dhe të ofrojnë zgjidhje për mangësitë e konstatuara me qëllim përmirësimin e performancës së funksionimit të aplikacionit e-inspektimi, si dhe të merren masa për sigurimin e internetit në pajisjet tablet të inspektorëve të ISHTI në mënyrë që inspektorët të ushtrojnë veprimtarinë e tyre inspektuese në terren pandërprerje.

## IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

### A. MASA ORGANIZATIVE

**1.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial nuk disponon një strategji institucionale, mungesa e të cilës sjell mangësi në vendosjen e prioriteteve të institucionit si dhe mungesën e pasqyrimin të objektivave të lidhura me burimet dhe instrumentet e nevojshme për matjen e tyre.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën (III.2.1) faqe (12-16) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**1.1.Rekomandimi:** Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë të marrin masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë institucionale ku të përfshihen edhe elementë të teknologjisë së informacionit, me qëllim identifikimin dhe zhvillimin e objektivave institucionale.

*Në vijimësi*

**2.Gjetje nga auditimi:** Rregullorja e brendshme institucionale nuk përputhet me veprimtarinë reale të ISHTI-t, pasi në rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të ISHTI-t nuk janë të përcaktuara detyrat dhe përgjegjësitë e gjithsecilit. Rregullorja fokusohet deri në nivelin e përcaktimit të rregullave të përgjithshme të strukturave dhe nuk përshkruan detyrat e strukturave të brendshme.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën (III.2.1) faqe (12-16) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**2.1.Rekomandimi:** Strukturat drejtuese në Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial të marrin masa për përditësimin e rregullores së brendshme, në të cilën të reflektohen dhe pasqyrohen ndryshimet institucionale strukturore, rregullat, detyrat si dhe përshkrimet e punës të të gjithë punonjësve të Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial.

### *Menjëherë*

**3.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se ISHTI akoma nuk e ka përfunduar procesin e kalimit tek Agjencia e Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, të burimeve njerëzore si dhe dorëzimin e Infrastrukturës TIK ekzistuese nën administrimin dhe inventarin e ISHTI-t, së bashku me të drejtat dhe detyrimet juridiko-civile, sipas përcaktimeve dhe afateve të vendosura në VKM Nr. 673, datë 22.11.2017, “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën (III.2.1) faqe (12-16) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**3.1.Rekomandimi:** Organet drejtuese në Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial të marrin masa për kalimin e strukturave përgjegjëse TIK si dhe kalimin e aktiveve të sistemeve të informacionit të ISHTI-t tek Agjencia e Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, së bashku me të drejtat dhe detyrimet juridiko-civile sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

### *Menjëherë*

**4.Gjetje nga auditimi:** Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial nuk disponon regjistër rrishtu ku të përfshiheshin edhe rrishtet që lidhen me teknologjinë e informacionit. Duke mos realizuar identifikimin e rrishteve, inspektorati rrishtikon që ngjarjet të përsëriten dhe mënyra dhe koha e zgjidhjes së tyre është e papërcaktuar duke rrishtikon mbarëvajtjen e punës. Gjithashtu institucioni nuk ka të dokumentuar një plan masash për identifikimin, trajtimin e gabimeve, problemeve dhe incidenteve që mund të ndodhin në infrastrukturën TI.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën (III.2.2) faqe (16-22) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**4.1.Rekomandimi:** Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial të marrë masa për identifikimin dhe analizimin e rrishteve për Teknologjinë e Informacionit me qëllim analizimin dhe vlerësimin e rrishteve dhe përmbushjen e objektivave të institucionit. Gjithashtu të marrin masa për hartimin e një plan veprimi për identifikimin, raportimin, trajtimin dhe dokumentimin e incidenteve.

### *Menjëherë dhe në vijimësi*

**5.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se ambienti ku është lokalizuar rack-u që përmban infrastrukturën network routerat, swich, etj, nuk përmbush kushtet standarde të përcaktuara në Rregulloren për ndërtimin e dhomës së serverëve (Versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën (III.2.2) faqe (16-22) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**5.1.Rekomandimi:** Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë të marrin masa për përmirësimin dhe standartizimin e infrastrukturës network me qëllim sigurimin e kushteve optimale për ofrimin e shërbimit dhe mbarëvajtjen e punës pa ndërprerje.

### *Menjëherë dhe në vijimësi*

**6.Gjetje nga auditimi:** Hyrja kryesore në godinën e ISHTI-t është e kontrolluar nga një sistem aksesit për hyrje-daljet e punonjësve të ISHTI-t por sistemi i ngritur përgjithësisht nuk përdoret nga stafi me qëllim monitorimin e lëvizjeve dhe hyrje daljeve, gjë e cila kompromenton nivelin e sigurisë së aksesit në ambientet fizike të ISHTI-t, duke qenë se në këtë godinë ndodhen dhe laboratorët e ndryshëm për kryerjen e analizave të produkteve dhe nënprodukte të naftës.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën (III.2.2) faqe (16-22) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**6.1.Rekomandimi:** Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial të marrë masa për përdorimin dhe monitorimin e sistemit të aksesit hyrje-dalje nga i gjithë stafi i institucionit me qëllim rritjen e sigurisë në ambientet fizike të ISHTI.

### *Menjëherë dhe në vijimësi*

**7.Gjetje nga auditimi:** Shërbimet që ofron teknologjia e informacionit në ISHTI mbështetet në një infrastrukturë IT jo të konsoliduar dhe në disa pjesë është e amortizuar, konkretisht:

- Pajisjet Pc kanë parametra minimale specifike dhe përgjithësisht kanë të instaluar sistemin operativ “Windows 7”, sistem për të cilin edhe vetë “Microsoft” që është prodhuesi i tij e ka

ndërprere suportin për sistemin dhe nuk e rekomandon përdorimin e tij në vijimësi, duke i bërë pc-të e punonjësve dhe rrjetin network të ISHTI-t vulnerabël ndaj sulmeve dashakeqe.

- Pajisjet Pc nuk kanë të instaluar software Antivirus;

-Sistemet e operemit apo edhe software-t (si Office) e instaluar nëpër pc janë të pa licencuara;

- Pajisjes periferike si printera janë kryesisht modele të vjetra por edhe të amortizuara, ku në të shumtën e rasteve, vështirë të gjendet bojë, pasi janë me bojra me rezervuar të lëngshëm ose “ink cartridge”.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën (III.2.2) faqe (16-22) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**7.1.Rekomandimi:** Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë të marrë masa për përmirësimin, pajisjen dhe standartizimin e infrastrukturës TIK për punonjësit e administratës së ISHTI, me qëllim krijimin e kushteve optimale për përmbushjen e detyrave gjatë veprimtarisë së punës dhe mbarëvajtjen e punës pa ndërprerje.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**8.Gjetje nga auditimi:** Grupi i auditimit shqyrtoi regjistrat e parashikimeve dhe të realizimeve të prokurimit publik nga i cili rezultoi se vlera e fondit limit në regjistrat e realizimeve në Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial nuk rakordojnë me vlerat reale të procedurave të prokurimit. Nga dokumentet shkresore si dhe nga komunikimi verbal me personat përgjegjës në institucion, rezultoi se kjo ka ardhur si pasojë e mos përditësimit të të dhënave ashtu siç parashikohet edhe në dispozitat ligjore në nenin 3 dhe 4 të VKM nr. 285 mbi regjistrin e parashikimeve dhe të realizimeve.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën (III.2.3) faqe (23-33) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**8.1.Rekomandimi:** Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial në të ardhmen të marrë masa për rakordimin e të dhënave në sistemin e APP për regjistrat e realizimit në mënyrë që vlerat në regjistrin e realizimeve të jenë vlerat reale të cilat janë përdorur për realizimin e një procedure prokurimi, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

*Menjëherë*

**9.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i tre procedurave të prokurimit me vlerë të vogël me objekt:

-“Shërbim mirëmbajtje për pajisje elektronike”, për vitin 2020;

-“Bojra printeri, fotokopje, tonera”; për vitin 2021

-“Shërbim mirëmbajtje për pajisje elektronike”, për vitin 2021,

u konstatuan mangësi në:

-firmosjen dhe protokollimin e procesverbalit për përlllogaritjen e fondit limit si dhe procesverbalin mbi kalimin tek operatori ekonomik i radhës;

-në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël të sipërpërmendura, asnjë nga anëtarët e komisionit nuk është ekspert i fushës, në kundërshtim me nenin 75/1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 parashikon se komisioni i vlerësimit të ofertave përbëhet nga jo më pak se tre persona, ku të paktën një prej anëtarëve është ekspert i fushës;

-për të treja procedurat e prokurimit nuk është hartuar raporti përmbledhës, në kundërshtim me përcaktimet ligjore në nenin 84 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

- për të dyja procedurat e prokurimit me objekt “Shërbim mirëmbajtje për pajisje elektronike”, Autoriteti Kontraktor (ISHTI) dhe Operatori Ekonomik nuk kanë nënshkruar kontratë ndërmjet palëve, në kundërshtim me përcaktimet e parashikuara në nenin 15/2 të ligji nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” si dhe në nenin 85 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën (III.2.3) faqe (23-33) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**9.1.Rekomandimi:** Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial në cilësinë e Autoritetit Kontraktor dhe personat e autorizuar mbi hartimin dhe ndjekjen e procedurave të prokurimit,

të marrin masa që për çdo procedurë prokurimi që do të zhvillojë në vijimësi të përmbushen përcaktimet e dispozitave ligjore dhe rregullative në fuqi.

#### *Menjëherë dhe në vijimësi*

**10.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se:

- Detyra e administratorit të sistemit në rolin e Administratorit të Inspektoratit Shtetëror nuk është e atribuar me anë të shkresës zyrtare nga organet drejtuese të ISHTI-t në mënyrë që të përcaktohen qartë të drejtat dhe detyrat e administratorit të sistemit, duke mos plotësuar kërkesat e përcaktuara në nenin 11, pika 9 të udhëzimit nr. 15 datë 07.05.2015 “Për miratimin e rregullave, Për përcaktimin e procedurave dhe mënyrave, për përdorimin e portalit unik të inspektimit “e-Inspektimi” të Inspektoratit Qendror.

- Nuk disponohet një akt rregullativ i dokumentuar dhe i miratuar për administrimin/menaxhimin e përdoruesve, në të cilën të jenë të përcaktuara procedurat që do të ndiqen për krijimin, fshirjen, ndryshimin e roleve dhe të të drejtave, ndryshimin e fjalëkalimeve të përdoruesve të ISHTI-it.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën (III.2.4) faqe (34-51) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**10.1.Rekomandim:** Organet drejtuese të Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial të marrin masa për përcaktimin e administrator-it të sistemit dhe përgjegjësive dhe të drejtave të tij në rolin e Administratorit të Inspektoratit Shtetëror sipas përcaktimeve rregullatore. Gjithashtu të marrin masa për të hartuar dhe miratuar një akt rregullativ për administrimin/menaxhimin e përdoruesve aktiv dhe jo aktiv të ISHTI, në të cilën të jenë të përcaktuara procedurat që ndiqen për krijimin, fshirjen, ndryshimin e roleve dhe të të drejtave, ndryshimin e fjalëkalimeve të përdoruesve të Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial. Të merren në konsideratë praktikët e përcaktuara në rregulloren për “Administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike” miratuar nga AKCESK.

#### *Menjëherë*

**11.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se:

- Fjalëkalimi i secilit përdorues në sistemin e-inspektimi në momentin e çeljes, sapo logohet përdoruesi (first log-in) me fjalëkalimin fillestar nuk të shfaqet automatikisht tabela e cila të kërkon vendosjen e fjalëkalimit të ri, ruajtjen e tij dhe rilogimin përsëri me anë të fjalëkalimit të ri.

- Sistemi nuk e ka të parametrizuar që pas një periudhe të standardizuar 30 ditore, automatikisht të të kërkojë rigjenerimin e fjalëkalimit.

- Nuk janë dokumentuar politikët e sigurisë të implementuara për përdoruesit e sistemit, si dhe detyrimet që nevojiten të aplikohen në fjalëkalimet e tyre, bazuar në pikën 4 “Kërkesat e Sigurisë” pika a. të rregullores për “Administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike” të miratuar nga AKCESK me urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019.

- Nuk janë dokumentuar politikët e sigurisë të implementuara për fjalëkalimet e sistemeve qendrore dhe administrimit bazuar në pikën 4 “Kërkesat e Sigurisë” pika b. Të rregullores për “Administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike” miratuara nga AKCESK me urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019.

- Mbështetur në manualin e përdorimit për burimet njerëzore të sistemit për shtimin e një përdoruesi të ri është e detyrueshme që të vendoset një foto, por nga verifikimi në sistem rezultuan që ka disa përdorues të ISHTI-t që nuk kanë foto.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën (III.2.4) faqe (34-51) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**11.1.Rekomandimi:** Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial në bashkëpunim me Inspektoratin Qendror (IQ) të marrin masa për të dokumentuar politikët e sigurisë të implementuara për përdoruesit e sistemit, si dhe detyrimet që nevojiten të aplikohen në fjalëkalimet e tyre sipas përcaktimeve rregullatore të AKCESK. Gjithashtu të merren masa për adresimin e çështjeve të konstatuar nga grupi i auditimit, me qëllim rritjen e sigurisë së identifikimit të përdoruesve.

**12.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi manualët e përdorimit të aplikacionit “e-inspektimi” u konstatua se:

- Manualët e përdorimit të sistemit nuk janë të miratuara nga asnjë prej organeve drejtuese të IQ apo ASKHI-t, si institucione që kanë në pronësi apo administrojnë sistemin e-inspektimi. Këto manuale janë në versionin e dorëzuar nga OE që ka implementuar sistemin.
- Manualët e sistemit janë hartuar që në vitin 2017, vetëm në versionin fillestar që janë gjeneruar në momentin që është implementuar sistemi dhe nuk kanë pësuar asnjë ndryshim, përditësim, pavarësisht ndryshimeve të ndodhura në funksionalitetin e sistemit, ndryshimet strukturore të burimeve njerëzore, etj.
- Manualët e përdorimit të sistemit nuk janë të ndarë sipas funksionaliteteve të inspektorateve, por të njëjtët manuale përdoren për të gjithë inspektoratet, pavarësisht fushës së veprimit që mbulojnë. Rolet dhe përgjegjësitë nuk janë të reflektuar apo përditësuar në manualët e sistemit.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën (III.2.4) faqe (34-51) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**12.1.Rekomandimi:** Inspektorati Qendror si institucioni që bashkërendon dhe mbështet veprimtarinë e inspektorateve shtetërore të përditësojë dhe miratojë, manualët e përdorimit të sistemit e-inspektimi duke reflektuar ndryshimet institucionale, strukturore dhe kompjuterike të ndodhura në inspektoratet shtetërore.

*Brenda vitit 2023 dhe në vijimësi*

**13.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi funksionalitetin e sistemit e-inspektimi u konstatua se:

Në modulën e “çështjeve të inspektimit” u konstatua se:

- Në disa raste gjatë zhvillimit të procesit inspektues, përdoruesve u shfaqën problematika mbi gjenerimin e vendndodhjes në tablet;
- Në momentin kur inspektori në çështjen përkatëse e krijon si ri-inspektim ato në sistem dalin të krijuara dy herë;
- Në disa raste është vërejtur se inspektorët, pasi gjenerojnë dokumentet si, Proces Verbalin, Listë Verifikimin dhe Vendimin Përfundimtar, statusi i këtyre çështjeve nuk del “Mbyllur” por vazhdon të jetë në progres;
- Përgjatë vitit 2022 janë hasur raste në versionin web dhe mobile ku sistemi nuk hapej dhe shfaqte error: “Service is unaviable” dhe “HTTP error 503”;
- Në disa raste në versionin web të sistemit e-inspektimi është hasur një error i cili shfaqej: “Lidhje me serverin dështoi”;
- Gjatë procesit të inspektimit është hasur një problematikë nga inspektorët të cilët pasi mbyllin procesin e inspektimit në sistem dhe më pas u duhet të dërgojnë në format elektronik “e-mail” të dhënat përkatëse, u konstatua se ky e-mail nuk shkon në destinacionin e përcaktuar;
- Kur krijohen çështjet në modulën e çështjeve dhe programimit, emri i një subjekti që përsëritet më shumë se 15 herë, nuk mund të regjistrohet në sistem. Për këtë arsye për të futur të gjithë subjektet e programuara në planin vjetor, ato regjistrohen në sistem në modulën e-inspektime/skeduli të çështjeve, me statusin “të programuara”. Praktikisht plani vjetor është në letër por nuk mund të hidhet i gjithi në sistem për shkak të kësaj problematike mbi përsëritjen e të njëjtit nipt. Kjo gjë krijon probleme pasi ka kompani të cilat kanë më shumë se një degë në të gjithë vendin por kanë një nipt të vetëm. Pra praktikisht këto subjekte nuk mund të inspektohen më shumë se 15 herë për shkak të pengesës së trajtuar më lart në sistem, edhe pse kanë më shumë degë në të gjithë vendin;
- Tek moduli i çështjeve të inspektimit nuk shfaqen të gjitha ri-inspektimet dhe kur kërkohet me arsyen ri-inspektim.

Në modulën “krijo çështje” u konstatua se:



-Në fazën e një procesi inspektimi jashtë planit vjetor dhe mujor, mungon mundësia e zgjedhjes së një arsyeje tjetër përveç atyre të paracaktuara në sistem. Mundësia e shtimit të arsyeve ose argumenteve sipas argumenteve specifike që inspektori e gjykon sipas situatës që konstaton, do të lehtësonte procesin e inspektimit në fazë;

-Në modulën e çështjeve të inspektimit tek fusha “inspektori”, përdoruesi nuk ka një opsion zgjedhjeje për të shkruar ose për të kërkuar (search) emrin e plotë të inspektorit që do të shtojë ose përzgjedhë;

-Përditësimi i degëve të subjektit nuk realizohet automatikisht tek fusha bizneset pa bërë search manual tek fusha bizneset.

Në modulën e “programimit” u konstatua se:

-Inspektorët e larguar duhet të jenë jo aktiv të paselektueshëm kur krijojnë çështje “Tek përcaktimi i programeve mujore”;

Në modulën e “skeduli i çështjeve” u konstatua se:

Sistemi nuk të ofron mundësi që të zgjedhësh një arsye tjetër përveç asaj të paracaktuarës dhe nuk ke mundësi të upload-osh dokumentin justifikues që citohet në përshkrimin e anulimit. Kjo gjë ndikon negativisht, në ndërprerjen e gjurmës së auditimit, pasi për të parë të gjithë procesin në sistem se pse është anuluar një çështje, do të duhet ta lexosh numrin e shkresës së hedhur manualisht në sistem dhe pastaj të shkosh në zyrën e protokoll arkivës për të marrë dokumentin justifikues me argumentet përkatëse.

Mbi shtyrjen e një procesi inspektues

Në rastet kur një proces inspektimi shtyhet për një arsye të caktuar dhe procesi i inspektimit nuk realizohet në periudhën e përcaktuar në autorizimin e parë të Kryeinspektorit, atëherë procesi duhet të rivijojë me një autorizim të ri që shtyhet në periudhën për javën pasardhëse. Nga auditimi u konstatua se sistemi e-inspektime nuk ka element kontrolli mbi këtë fazë dhe i lejon inspektorët që të procedojnë në sistem me procesin e inspektimit me plotësimin e hapave të mëtejshëm edhe pse nuk është hedhur akoma autorizimi i ri në sistem që duhet aprovuar nga Kryeinspektori. Në këto raste autorizimi i ri miratohet pasi ka mbaruar i gjithë procesi i inspektimit dhe është dhënë dhe vendimi përfundimtar.

Pra sistemi nuk ia ndërpret procesin inspektorit që të vazhdojë në hallkat e tjera por ja lejon atij të vazhdojë të kryejë procesin inspektues pa u miratuar akoma autorizimi i ri nga Kryeinspektori.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën (III.2.4) faqe (34-51) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**13.1.Rekomandim:** Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial në bashkëpunim me Inspektoratin Qendror të analizojë dhe adresojë tek ofruesi i shërbimit të mirëmbajtjes parregullsitë, mangësitë e konstatuara nga auditimi dhe të ofrojnë zgjidhje për to me qëllim përmirësimin e performancës së funksionimit të sistemit e-inspektimi, si dhe të merren masa për shtimin e funksionaliteteve të reja në sistemin e-inspektimi sipas nevojës së përdoruesve në sistem.

***Brenda vitit 2023***

**14.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se:

-Versioni mobile i sistemit e-inspektimi vazhdimisht punon me ndërprerje dhe ka probleme me ecurinë normale të punës duke ndikuar negativisht në veprimtarinë e punës së inspektorëve. Ky version ka nevojë për përditësime dhe upgrade;

-Në faqen e parë të versionit mobile pasi inspektori logohet, i shfaqen të gjitha çështjet e hapura për të gjithë muajin, pra në qoftë se inspektorit do ti nevojitet të shohë një çështje të tijën, i duhet të bëjë search për ta gjetur;

-Gjatë krijimit të një çështje në sistem, inspektori i cili po krijon çështjen për të shtuar inspektorin e dytë në çështje, i duhet të bëjë scroll të gjithë listën e emrave të inspektorëve pasi sistemi nuk ta ofron mundësinë të bësh search në këtë fushë;

-Tek fusha “Aktiviteti ILO” që zgjedh inspektori, gjatë krijimi të një çështjeje, nuk i shfaqet mundësia për të zgjedhur një lloj tjetër subjekti që ka p.sh bombula ose pajisja nën presion përveç formës GLN (Gaz i lëngshëm). Pra sistemi të ofron të zgjedhës vetëm këtë mundësi GLN pavarësisht se subjekti që do të inspektohet nuk ka këtë lloj bombule, inspektori është i detyruar ta zgjedhë këtë mundësi pasi nuk ka opsion tjetër;

-Sistemi nuk e ndalon të procedohet një çështje të cilës i është përcaktuar afati i fillimit dhe mbarimit. Pra në qoftë se një çështje ka të përcaktuar në autorizimin përkatës afatin e fillimit dhe mbarimit të saj, një inspektor mund të punojë në këtë çështje edhe pasi të ketë kaluar afati i përfundimit të përcaktuar në autorizim. Pra çështja nuk mbyllet kur është e përcaktuar në sistem në autorizim por në të mund të punohet deri kur ta mbyllë inspektori;

-Tek Lista e verifikimit të subjekteve që plotësohet nga inspektorët në terren, në rast se inspektorët verifikojnë që një subjekt ka një pajisje nën presion për të cilën nuk disponon dokumentacionin e nevojshëm atëherë inspektorit nuk i shfaqet një mundësi që të zgjedhë shënimin, që subjekti i inspektuar ti lihet afat për të plotësuar dokumentacionin e nevojshëm për pajisjen nën presion, pa qenë nevoja për plotësimin e të gjithë listës së verifikimit;

-Përgjatë vitit 2022 janë hasur raste në versionin mobile në tabletë ku pasi inspektorët logohen nuk ju dalin çështjet e tyre në progres edhe kur në sistem janë të hapura;

-Ka raste që sistemi nuk merr vendndodhjen e saktë në zona të caktuara kur nuk ka sinjal të mirë. Në këto raste inspektorëve ju duhet ta ruajnë çështjen në mënyrë që ta sinkronizojnë në një moment të dytë kur të kenë sinjal interneti;

-Inspektorët duhet të përdorin internetin e tyre ose të subjektit që po inspektojnë për të ngarkuar dhe sinkronizuar çështjen me të cilën po punojnë, pasi pajisjet tablet nuk kanë internet për ta kryer këtë proces.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën (III.2.4) faqe (34-51) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**14.1.Rekomandimi:** Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial në bashkëpunim me Inspektoratin Qendror të analizojë dhe adresojë tek ofruesi i shërbimit të mirëmbajtjes parregullsitë, mangësitë e konstatuara nga auditimi në aplikacionin mobile të sistemit e-inspektimi. Të përditësojnë aplikacionin mobile dhe të ofrojnë zgjidhje për mangësitë e konstatuara me qëllim përmirësimin e performancës së funksionimit të aplikacionit e-inspektimi, si dhe të merren masa për sigurimin e internetit në pajisjet tablet të inspektorëve të ISHTI në mënyrë që inspektorët të ushtrojnë veprimtarinë e tyre inspektuese në terren pandërprerje.

*Brenda vitit 2023*

---

*Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi*

## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**